


ANKETA MBI KËNAQSHMËRINË E QYTETARËVE



QERSHOR 2022

DEMOS Decentralisation
and Municipal Support

ANKETA MBI KËNAQSHMËRINË E QYTETARËVE

QERSHOR 2022

Ky raport është përgatitur nga UBO Consulting për projektin DEMOS, zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation.

Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e zyrës së BE-së në Kosovë, Zvicrës, Suedisë, Norvegjisë dhe të HELVETAS Swiss Intercooperation.

©DEMOS Publikuar: qershor 2022 Prishtinë/Pristina, Kosovë

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	5
Gjetjet kryesore	5
Hyrje	6
Qasja e metodologjisë	6
Qasja sasiore	6
Qasja cilësore	7
Rezultatet e studimit	7
Qasja në informacione	7
Pjesëmarrja (angazhimi) e qytetarëve	12
Roli i Kuvendit të Komunës	20
Menaxhimi komunal	24
Ofrimi i shërbimeve	28
Kënaqshmëria e përgjithshme me komunat	31
Përfundimi	35
Shtojca	36
Tabelat tërthore (crosstabs) me komunat	36
Pyetësi i anketës	87
Udhëzues për Diskutimin e Fokus Grupeve	93

Lista e figurave

Figura 1. Sa jeni të informuar lidhur me vendimet që i merr komuna juaj?	8
Figura 2. Në çfarë formash komunikohen këto vendime?	9
Figura 3. A i keni vizituar opsionet e përmendura gjatë 12 muajve të fundit?	10
Figura 4. Për çfarë arsye?	11
Figura 5. A e keni gjetur informacionin/shërbimin e kërkuar?	11
Figura 6. Sa lehtë i keni gjetur informacionet që ju kanë nevojitur?	11
Figura 7. A i keni kuptuar lehtësisht informacionet që i keni gjetur të publikuara nga komuna?	12
Figura 8. Si keni ndërevepruar me komunën tuaj gjatë 12 muajve të fundit (përveçse gjatë fushatave zgjedhore)?	13
Figura 9. Si keni ndërevepruar me komunën tuaj gjatë 12 muajve të fundit (përveçse gjatë fushatave zgjedhore)? Zbërthimi sipas gjinisë	13
Figura 10. Çfarë çështje keni ngritur pranë komunës?	14
Figura 11. Çfarë çështje keni ngritur pranë komunës? Zbërthimi sipas gjinisë	15
Figura 12. Si ju angazhon komuna gjatë takimeve publike?	15
Figura 13. Deri në çfarë mase pajtoheni se autoritetet komunale i marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike?	16
Figura 14. Nëse keni ngritur një çështje, a iu është përgjigjur komuna për çështjen që e keni ngritur?	17



Figura 15. Nëse po, sa ditë iu deshën komunës për t'iu përgjigjur çështjes që kishit ngritur? Ndarja gjinore	17
Figura 16. Sa të kënaqur ishit me reagimin e komunës për çështjen që kishit ngritur?	17
Figura 17. A do të ishit të gatshëm për të përdorur platformat digjitale për t'u angazhuar me komunën tuaj?	18
Figura 18. A keni informata se si ndahet buxheti i komunës?	18
Figura 19. Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve të projekteve në buxhetin komunal?	19
Figure 20. Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve të projekteve në buxhetin komunal? Ndarja gjinore	20
Figura 21. Deri në çfarë shkalle jeni në dijeni për rolin dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të komunës?	21
Figura 22. A keni takuar ndonjë asambleist të kuvendit të komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike?	21
Figura 23. A keni takuar ndonjë asambleist të kuvendit të komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike? Ndarja gjinore	22
Figura 24. A keni marrë pjesë në ndonjë seancë të Kuvendit të Komunës në 12 muajt e fundit?	22
Figura 25. Cila është arsyeja?	23
Figura 26. A i keni ndjekur seancat e kuvendit komunal përmes mediave (TV/radio/media sociale)?	23
Figura 27. Deri në çfarë mase pajtoheni që Kuvendi Komunal arrin të mbajë përgjegjës ekzekutivin (kryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale)?	24
Figura 28. Sa jeni të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal?	24
Figura 29. Sa jeni të kënaqur me projektet/punimet e infrastrukturës publike në komunën tuaj?	25
Figura 30. Sipas jush, cilat kritere merren parasysh gjatë procesit të rekrutimit të punëtorëve në komunë?	26
Figura 31. A mendoni se komuna juaj u ofron grave mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse (arsim, shëndetësi, institucione kulturore dhe pozita politike në komunë	27
Figura 32. A keni përdorur shërbimet komunale të mëposhtme në 12 muajt e fundit?	28
Figura 33. Ju lutemi vlerësoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me shërbimin e mëposhtëm komunal	29
Figura 34. Sa jeni të kënaqur me planifikimin hapësinor (zhvillimi komunal dhe planifikimi i përdorimit të tokës)?	30
Figura 35. Ju lutemi vlerësoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me...	32
Figura 36. A jeni të kënaqur me jetesën në komunën tuaj?	32
Figura 37. A mendoni se komuna juaj është në drejtimin e duhur për të qenë një vend më i mirë pas 5 vitesh?	33
Figura 38. A keni votuar në zgjedhjet e fundit komunale (2021)?	34

Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport janë paraqitur gjetjet e "Anketës mbi Kënaqëshmërinë e Qytetarëve", një studim i porositur nga HELVETAS Swiss Intercooperation/Projekti DEMOS, dhe i kryer nga UBO Consulting. Si qëllim i kësaj ankete ka qenë hulumtimi i qëndrimeve dhe perceptimeve të qytetarëve të Kosovës lidhur me shërbimet publike dhe qeverisjen e tyre lokale.

Gjetjet kryesore

- Shumica e të anketuarve (78%) janë të informuar për vendimet që merr komuna e tyre, ndërsa 21% nuk janë të informuar. Sipas qytetarëve të anketuar, vendimet komunale komunikohen përmes komunikimit verbal/gojë-më-gojë (47%), Facebook-ut (44%) dhe TV/Radiove lokale (39%). Arsyet kryesore se përse të anketuarit vizitojnë faqet dhe/ose uebfaqet e komunës së tyre në Facebook janë hapjet e vendeve të punës (71%), pasuar nga subvencionet (38%) dhe informacionet në lidhje me dëgjimet publike (34%). Më shumë se gjysma e të anketuarve (62%) janë të gatshëm të përdorin platforma digjitale për të qenë të inkuadruar në zhvillimet e komunave të tyre.
- Shumica e të anketuarve (74%) nuk kanë pasur asnjë ndërveprim me komunën e tyre gjatë 12 muajve të fundit. Ata të cilët kanë pasur ndërveprim me komunën, më së shumti kanë ngritur çështje të lidhura me infrastrukturën lokale (53%), çështje rreth mjedisit (47%) ose arsimit (45%). Një pjesë më e vogël e të anketuarve kanë ngritur çështje për shëndetësinë (35%) dhe sigurinë publike (34%). Shumica e të anketuarve (83%) kanë deklaruar se komuna nuk ka reaguar ndaj çështjeve të cilat i kanë ngritur ata. Pjesa e mbetur prej 17% kanë pritur mesatarisht 17 ditë për të marrë përgjigje nga komuna.
- Vetëm 23% e të anketuarve e dinë se si ndahet/shpërndahet buxheti komunal. Shumica e të anketuarve (78%) janë të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve në buxhetin komunal, ndërsa 22% nuk janë të kënaqur me këtë. Përveç kësaj, më shumë se gjysma e qytetarëve të anketuar në mbarë Kosovën (56%) kanë raportuar se kanë qenë deri diku të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal.
- Më pak se gjysma e të anketuarve (41%) dinë mesatarisht për rolin dhe përgjegjësitë e këshilltarëve komunal, dhe një pjesë më e vogël e të anketuarve (31%) dine pak për këtë. Shumica e të anketuarve (71%) nuk janë takuar me asnjë këshilltar komunal në 12 muajt e fundit për të diskutuar rreth çështjeve të përbashkëta publike. Përveç kësaj, shumica e të anketuarve (86%) nuk kanë marrë pjesë në asnjë seancë të Kuvendit të komunës gjatë 12 muajve të fundit. Arsyet se përse të anketuarit nuk kanë marrë pjesë në ngjarje të tilla përfshijnë: mungesën e interesit (43%), mungesën e informacionit (37%) dhe mungesën e kohës së lirë (20%).
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) besojnë se komuna e tyre i ofron grave deri diku mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse, ndërsa vetëm 13% besojnë se këto mundësi ofrohen në masë të madhe.
- Shërbimet komunale më të përdorura nga të anketuarit përfshijnë: lejet e ndërtimit (85%), shërbimet administrative (77%), shërbimet e shëndetit primar (69%) dhe shërbimet e transportit publik (60%). Numër pak më i vogël i të anketuarve (49%) kanë përdorur hapësirat publike dhe shërbimet e arsimit para-universitar (47%).



- Shumica e të anketuarve (78%) deklarojnë se janë të kënaqur me shërbimet e komunave të tyre, me performancën e përgjithshme (75%), me administratën lokale (75%) dhe me kuvendin komunal (71%). Rezultatet e anketës tregojnë gjithashtu se 73% e të anketuarve besojnë se komuna e tyre është në drejtimin e duhur për të arritur një pozitë më të mirë pas pesë viteve.

Hyrje

Anketa mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve është hulumtim që synon të eksplorojë qëndrimet dhe perceptimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me shërbimet publike dhe qeverisjen e tyre lokale. AKQ është duke u realizuar në kuadër të Programit për Decentralizim dhe Mbështetje të Komunave. Objektivi i përgjithshëm i DEMOS është të mbështesë Kosovën në procesin e saj të tranzicionit drejt një shteti demokratik dhe të decentralizuar, ku komunat ushtrojnë një qeverisje sociale gjithëpërfshirëse dhe ofrojnë shërbime efektive duke iu përgjigjur prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve.

Ky raport pasqyron rezultatet më të rëndësishme të anketës dhe diskutimet e fokus grupit. Raporti ofron informacione që mund të përdoren për të shqyrtuar se çfarë mendojnë qytetarët anembanë Kosovës për çështjet më urgjente brenda domenit të komunave, si dhe për të ofruar komente për punën e komunave dhe zyrtarëve të tyre të zgjedhur. Supozohet se duke pasqyruar çështjet më urgjente, komunat mund të gjejnë nxitjen për të reaguar. Më tej, rezultatet nga kjo anketë mund të përdoren nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunat individuale për vlerësimin e efektivitetit të tyre në ofrimin e shërbimeve publike, të cilat përfundimisht mund të çojnë në përmirësimin e shërbimeve dhe rrjedhimisht, në ngritjen e cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Raporti i Anketës mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve është ndarë në gjashtë seksione kryesore, e që janë: Qasja në informacione, Pjesëmarrja e qytetarëve, Roli i Kuvendit të komunës, Menaxhimi i Komunës, Ofrimi i Shërbimeve dhe Kënaqshmëria e Përgjithshme me Komunat. Secili prej këtyre seksioneve paraqet të dhëna sasiore dhe cilësore të cilat janë mbledhur për qëllimin e këtij studimi.

Qasja e metodologjisë

Ky studim është realizuar duke përdorur qasjen e një metodologjie të përzier, që përdor metoda sasiore dhe cilësore për mbledhjen e të dhënave.

Qasja sasiore

Anketa është realizuar përmes intervistave personale, duke përdorur teknikën CAPI (Intervista personale me ndihmën e kompjuterit). Kjo anketë është realizuar në 38 komuna në mbarë Kosovën, ku janë përfshirë shqiptarët, serbët dhe minoritetet tjera. Më konkretisht, të anketuarit shqiptarë janë intervistuar në 35 komuna, ndërsa të anketuarit serbë në 17 komuna. Anketa është realizuar përmes intervistave ballë-për-ballë, ndërsa të dhënat janë përpunuar përmes një softueri për menaxhimin e anketave.

Struktura e mostrimit vjen nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011, që është një format standard në fushën e hulumtimit të opinionit publik. Duke përdorur strukturën e popullsisë dhe shpërndarjen e saj janë përcaktuar kuotat sipas përkatësisë etnike (mbivlerësimi i komuniteteve pakicë), komunave dhe llojit të vendbanimit (urban dhe rural). Kjo strukturë mundëson shtrirjen e shtresëzuar në nivelin më të ulët të organizimit të mostrës së bazuar në popullsi.

Për të identifikuar problemet e mundshme që mund të lindin gjatë administrimit të pyetësorit në terren, UBO Consulting ka zhvilluar një pilot testim të pyetësorëve për t'i vërtetuar ata në përmbajtje dhe logjikë. Pilot testimi ka mundësuar të përcaktojë edhe besueshmërinë e pyetësorit, si dhe të matë kohën e nevojshme për të realizuar një intervistë me sukses. Gjatë kësaj faze, janë bërë modifikimet e nevojshme në pyetësor.

UBO Consulting ka realizuar punët e anketës në terren në periudhën midis 6 dhe 22 dhjetor 2021. Anketa është zhvilluar me përfaqësuesit e komuniteteve shqiptare dhe serbe, dhe është zhvilluar edhe në zonat urbane edhe në ato rurale, në mënyrë të barabartë.

Qasja cilësore

Për qëllime të këtij studimi, UBO Consulting ka përdorur edhe një metodë cilësore, përkatësisht fokus grupet. Kjo metodë kërkimore përdoret zakonisht për të nxjerrë informacione më të thella nga përvojat, besimet, perceptimet dhe sjelljet personale të pjesëmarrësve, përmes një ndërveprimi të moderuar të pjesëmarrësve.

Për sa i përket fokus grupeve, UBO Consulting ka realizuar 3 sosh. Diskutimet janë administruar si në vijim:

1. DFG me gratë e përkatësive etnike që flasin shqip
2. DFG me burrat e përkatësive etnike që flasin shqip
3. DFG me gratë dhe burrat e përkatësive etnike që flasin serbisht

Takimet e fokus grupeve janë mbajtur gjatë datave 16 deri më 29 dhjetor 2021. Qëllimi i këtyre takimeve të fokus grupeve ka qenë vërtetimi i rezultateve të nxjerra nga intervistat ballë-për-ballë. UBO Consulting, në bashkëpunim me DEMOS, ka hartuar udhëzuesin e diskutimit. Udhëzuesi i diskutimit është përbërë nga një pjesë e hyrjes dhe diskutimit, që i ka ofruar moderatorit një përmbledhje të çështjeve që duhet të diskutohen në këto takime.

Rezultatet e studimit

Qasja në informacione

Një nga qëllimet e këtij studimi ka qenë të kuptuarit më mirë i mënyrave se si i qasen të anketuarit informacioneve të lidhura me komunën e tyre. Kjo pjesë e raportit, ndër të tjera, paraqet të dhënat cilësore dhe sasiore për nivelin e informimit që të anketuarit kanë për vendimet komunale, mënyrat e komunikimit të vendimeve, vështirësinë për të gjetur dhe kuptuar informacionet e tilla, etj.

Grafiku më poshtë tregon se shumica e të anketuarve (78%) janë të informuar për vendimet që marrin komuna e tyre, ndërsa 21% nuk janë të informuar.

Gjatë analizimit të rezultateve në aspektin komunal, të anketuarit nga Suhareka kanë rezultuar si më të informuarit (70%) për vendimet që merr komuna e tyre, të pasuar ngushtë nga të anketuarit prej Mitrovicës së Veriut (69%) dhe Parteshi (64%). Nga ana tjetër, 74% e të anketuarve në Novobërdë kanë deklaruar se nuk janë të informuar fare për vendimet që merr komuna e tyre. Përveç kësaj, të anketuarit që kanë mungesë të informacionit rreth vendimmarrjes në komunën e tyre janë nga Hani i Elezit (68%) dhe Klina (64%).




Figura 1. Sa jeni të informuar lidhur me vendimet që i merr komuna juaj?

Për sa i përket boshllëkut të konsiderueshëm në informimin e qytetarëve lidhur me vendimet që marrin komunat e tyre, komponenti cilësor i studimit ka synuar të zbulojë arsyt/faktorët që mund të kenë ndikuar në keqinformimin e qytetarëve. Në përgjithësi, duket se qytetarët besojnë se për autoritetet komunale është më e dobishme që t'i mbajnë qytetarët në errësirë (mos t'i informojnë qytetarët) rreth vendimeve të tyre. Pjesëmarrësit e fokus grupeve të cilët kanë marrë pjesë në studim kanë deklaruar se shpeshherë ndodh që vendimet komunale apo shpalljet e vendeve të lira të punës të mos publikohen në kohën e duhur. Sipas tyre, publikimi i këtyre njoftimeve shumë afër përfundimit të afatit pengon procesin e rregullt të rekrutimit dhe mundëson informalitetin. Duke vepruar kështu, komunat i respektojnë rregullat e transparencës, megjithatë, ato përfshihen në akte të informalitetit (nepotizëm/anshmëri në procesin e rekrutimit) duke u shfaqur si shumë korrekt para publikut.

Duke hetuar më tej faktorët që kanë ndikuar në mungesën e informimit të qytetarëve lidhur me vendimet komunale, studimi ka zbuluar se komunat gjithashtu nuk i publikojnë rregullisht vendimet në uebfaqen e tyre. Për më tepër, informacionet në uebfaqen zyrtare të komunës nuk janë të postuara në gjuhët zyrtare të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Andaj, me mungesën e postimit të rregullt të informacioneve dhe mungesës së përfshirjes, qytetarët e Kosovës nuk janë të informuar siç duhet për vendimet që marrin komunat e tyre. Një tjetër arsye për zbrazëtirën e dukshme në informacione është identifikuar edhe mungesa e interesit të qytetarëve për t'iu qasur informacioneve. Pjesëmarrësit në studim kanë deklaruar se qytetarët nuk janë të informuar as për ekzistimin e uebfaqes zyrtare të komunës. Duke qenë kështu, burimi kryesor i informimit në mesin e qytetarëve mbetet shkëmbimi verbal i informacioneve. Informacionet lidhur me vendimet komunale komunikohen më tepër përmes thashethemeve/ komunikimit verbal/gojë-më-gojë, në vend të informimit përmes uebfaqes zyrtare të komunës.

Sipas të dhënave sasiore të mbledhura nga anketa, rreth 47% e të anketuarve kanë deklaruar se vendimet komunikohen përmes komunikimit verbal/gojë-më-gojë, pasuar nga 44% sosh që kanë deklaruar se informacionet komunikohen përmes Facebook-ut dhe

39% që kanë deklaruar informimin përmes TV/Radio lokale. Për më tepër, të anketuarit (29%) kanë pohuar se këto vendime publikohen në uebfaqen e komunës. Dhe e fundit, vetëm 8% e të anketuarve deklarojnë se informacionet komunikohen përmes postës.

Rezultatet e anketës sugjerojnë se komunikimi i vendimeve komunale përmes komunikimit verbal/gojë-më-gojë është një nga mjetet më të njohura për të përhapur informacione të tilla në shumicën e komunave të Kosovës. Rreth 96% e të anketuarve nga Kaçaniku informohen përmes komunikimit verbal/gojë-më-gojë, ndërsa vetëm nëntë për qind e të anketuarve të Mitrovicës së Veriut përdorin mënyrën e komunikimit verbal/gojë-më-gojë si formë e informimit lidhur me vendimet që merr komuna e tyre. Të dhënat tregojnë se të anketuarit (66%) e Prishtinës kryesisht informohen përmes uebfaqes së komunës së tyre lidhur me vendimet e tilla, ndërsa vetëm 1% e të anketuarve nga Istogu, Novobërda dhe Zveçani përdorin uebfaqen e komunës së tyre për tu informuar. Për më tepër, shumica e të anketuarve nga Suhareka informohen për vendimet komunale përmes Facebook-ut, ndërsa vetëm 6% e të anketuarve nga Novobërda bëjnë të njëjtën gjë. Rreth 76% e të anketuarve nga Prizreni kanë deklaruar se vendimet e marra nga komuna e tyre komunikohen përmes TV/Radios lokale. Në anën tjetër, sipas të anketuarve, zyrtarët komunalë nga Hani i Elezit nuk përdorin TV/Radion për të komunikuar vendimet e tyre tek qytetarët.




Figura 2. Në çfarë formash komunikohen këto vendime?

Kur janë pyetur lidhur me preferencën e tyre për kanalet e komunikimit që duhet të përdorin komunat gjatë komunikimit me qytetarët, të dhënat cilësore kanë identifikuar disa përgjigje. Në përgjithësi, pjesëmarrësit janë të mendimit se televizioni duhet të konsiderohet më shumë si kanal informues për çështjet, ngjarjet dhe vendimet komunale. Duke pasur parasysh se është një kanal mediatik që është i qashtë nga të gjithë qytetarët, pjesëmarrësit e kanë vlerësuar si formë të përshtatshme për komunikimin e informacioneve komunale tek qytetarët e tyre. Gjithashtu, ata kanë deklaruar se është e rëndësishme që komunat të organizojnë fushata vetëdijësuese dhe të ofrojnë udhëzime të shpejta për qasjen në uebfaqen zyrtare të komunës. Forma të tjera të komunikimit për thjeshtimin e qasjes në informacione të identifikuara në këtë studim përfshijnë dëgjimet publike, ndërmjetësimin e informacionit përmes një përfaqësuesi të lagjes, si dhe platformat e rrjeteve/mediave sociale.

E kundërta e kësaj, sa i përket shpërndarjes së informacioneve për grupmoshat e ndryshme (të rinj kundrejt të rriturve, etj.), pjesëmarrësit në studim kanë supozuar se kanalet mediatike si Radio dhe Televizioni konsiderohen si platforma më të përshtatshme për të informuar grupmoshat më të vjetra. Për më tepër, dëgjimet publike dhe ngjarjet e tjera ballë-për-ballë janë më të realizueshme për këto grupe, për shkak të edukimit dhe



mosnjohjes së tyre me teknologjinë moderne. Nga ana tjetër, grupmoshat më të reja informohen më gjerësisht përmes faqes zyrtare të komunës, Facebook-ut, portaleve të lajmeve dhe formave të tjera të komunikimit digjital.

Të anketuarit janë pyetur nëse gjatë 12 muajve të fundit kanë vizituar uebfaqen e komunës dhe/ose faqen e komunës në Facebook. Në bazë të rezultateve, 26% e të anketuarve kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit e kanë vizituar uebfaqen e komunës, ndërsa 45% e të anketuarve kanë deklaruar se e kanë vizituar faqen e komunës në Facebook. Megjithatë, përqindja e të anketuarve që kanë deklaruar se nuk e kanë vizituar asnjërën prej tyre gjatë 12 muajve të fundit ka qenë më e lartë (49%).

Të anketuarit nga Prishtina kanë vizituar më së shumti (60%) uebfaqen e komunës së tyre gjatë 12 muajve të fundit, ndërsa më pak se 1% e qytetarëve të anketuar nga Zveçani kanë pohuar se e kanë vizituar uebfaqen e komunës së tyre gjatë vitit të kaluar. Faqja e komunës në Facebook është më e popullarizuar në mesin e të anketuarve nga Suhareka (89%). Sipas rezultateve të anketës, 93% e të anketuarve të Novobërdës nuk e kanë vizituar as uebfaqen e komunës dhe as faqen në Facebook gjatë 12 muajve të fundit.




Figura 3. A i keni vizituar opsionet e përmendura gjatë 12 muajve të fundit?

Të anketuarve, që u janë përgjigjur pozitivisht pyetjes së mëparshme, më pas iu kërkua të elaborojnë arsyet se pse e kanë bërë këtë. Arsyet kryesore se pse të anketuarit vizitojnë faqet e Facebook-ut dhe/ose uebfaqet e komunave të tyre janë hapjet e vendeve të punës (71%), të pasuar nga subvencionet (38%) dhe informacionet që lidhen me dëgjimet publike (34%). Për më tepër, në 20% të rasteve, të anketuarit kanë thënë se i kanë vizituar faqet e lartpërmendura për të mbledhur informacione për buxhetin dhe shpenzimet komunale, si dhe informacione lidhur me tenderët publikë.

Nëse i zbërthejmë rezultatet në aspektin komunal, vërejmë se rreth 60% e të anketuarve nga Ranillugu kanë përdorur faqet e tilla për të marrë informacione lidhur me tenderët publikë. Sipas rezultateve të anketës, të anketuarit nga Suhareka kanë vizituar faqen e Facebook-ut dhe/ose uebfaqen e komunës për të marrë informacione lidhur me dëgjimet publike (66%). Për më tepër, me qëllim të kërkimit të vendeve të lira të punës, shumica dërrmuese e të anketuarve (93%) nga Shtërpca kanë vizituar faqet informative të komunës së tyre. Të dhënat tregojnë se të anketuarit nga Klina (92%) dhe Novobërda (66%) kanë vizituar faqet e tilla për t'u informuar rreth subvencioneve.




Figura 4. Për çfarë arsye?

Grafiku i mëposhtëm tregon se shumica e të anketuarve (76%) kanë gjetur informacionin/shërbimin e kërkuar në faqen e Facebook-ut dhe uebfaqen e komunës, ndërsa 24% sosh kanë deklaruar të kundërtën.

Të gjithë të anketuarit (100%) nga Mamusha dhe Malisheva kanë deklaruar se kanë gjetur informacionet që i kanë kërkuar, ndërsa të gjithë qytetarët e anketuar nga Zveçani kanë pohuar se nuk kanë gjetur atë që kërkonin në faqen e Facebook-ut dhe/ose uebfaqen e komunës.




Figura 5. A e keni gjetur informacionin/shërbimin e kërkuar?

Të dhënat tregojnë se të anketuarit më lehtë e kanë të gjejnë informacionet e nevojshëm në faqen e komunës në Facebook, sesa në uebfaqe e komunës. Sipas grafikut të mëposhtëm, shumica e të anketuarve kanë deklaruar se i kanë gjetur informacionet e nevojshme lehtë/shumë lehtë kur kanë vizituar uebfaqen e komunës (77%) ose faqen e komunës në Facebook (84%).




Figura 6. Sa lehtë i keni gjetur informacionet që ju kanë nevojitur?



Të dhënat cilësore të studimit mbështesin gjetjet që tregojnë se qytetarët zakonisht vizitojnë faqen e komunës në Facebook dhe uebfaqen zyrtare të komunës për t'iu qasur informacioneve. Informacionet që zakonisht kërkohen nga të anketuarit kanë të bëjë me shërbimet komunale, dëgjimet publike, çështjet e infrastrukturës dhe vendet e lira të punës. Pjesëmarrësit kanë deklaruar se faqja në Facebook është lehtësisht e qasshme, por nuk përditësohet dhe mungojnë informacionet përkatëse. Informacionet në uebfaqen zyrtare në anën tjetër duket se janë më shumë të natyrës së përgjithshme, sesa informacione specifike për vendimet apo veprimet komunale. Për më tepër, pjesëmarrësit në mënyrë alternative kanë ngritur çështjen se jo secili qytetar ka llogari në Facebook, dhe jo të gjithë janë të pajisur me aftësitë përkatëse për përdorimin e teknologjisë moderne si mjet për marrjen e informacioneve.

Të anketuarve iu është kërkuar të vlerësojnë nivelin e kuptueshmërisë së informacioneve të publikuara nga komunat. Shumica e të anketuarve (83%) kanë deklaruar se informacionet e publikuara nga komuna kanë qenë deri diku/shumë të kuptueshme, ndërsa 14% sosh kanë deklaruar se informacionet që kanë gjetur kanë qenë deri diku të pakuptueshme. Gjithashtu, 1% e të anketuarve kanë deklaruar se informacionet aspak nuk janë të kuptueshme.

Sipas rezultateve të studimit, të gjithë të anketuarit (100%) nga Juniku, Mamusha dhe Novobërda i vlerësojnë informacionet e publikuara nga komunat e tyre si të kuptueshme, krahasuar me gjysmën e të anketuarve nga Graçanica (52%) që kanë vlerësuar se nuk i kuptojnë informacionet.




Figura 7. A i keni kuptuar lehtësisht informacionet që i keni gjetur të publikuara nga komuna?

Pjesëmarrja (angazhimi) e qytetarëve

Kjo pjesë e raportit fokusohet në mënyrën se si angazhohen qytetarët kosovarë me komunat e tyre. Përmes kësaj pjese, lexuesi do të jetë në gjendje të ketë një pasqyrë lidhur me përqindjen e të anketuarve që marrin pjesë në takime publike, çështjet të cilat i ngritin qytetarët, nivelin e kënaqëshmërisë së tyre me përgjigjet e komunave, si dhe informacione të ndërlidhura me buxhetin komunal.

Grafiku në vijim tregon se rreth 74% e të anketuarve nuk kanë pasur ndonjë ndërveprim me komunën e tyre gjatë 12 muajve të fundit. Megjithatë, 16% e tyre deklarojnë se kanë marrë pjesë në takime publike, pasuar nga një përqindje më e vogël e të anketuarve (13%) që deklarojnë se kanë ndërvepruar me komunën përmes takimeve individuale dhe përmes iniciativave të përbashkëta të komunitetit (12%).

Pak më tepër se gjysma e të anketuarve (53%) nga komuna e Prishtinës kanë raportuar se gjatë 12 muajve të fundit kanë marrë pjesë në takime publike. Në anën tjetër, asnjë nga të anketuarit nga Kaçaniku dhe Novobërda nuk e kanë bërë të njëjtën gjë. Rreth 45% e

të anketuarve nga Dragashi kanë ndërvepruar përmes takimeve individuale, krahasuar me më pak se 1% të të anketuarve nga Novobërda që kanë marrë pjesë në takime të tilla. Sipas rezultateve të anketës, të anketuarit nga Novobërda (99%), Malisheva (98%) dhe Zubin Potoku (98%) nuk kanë ndërvepruar fare me komunat e tyre gjatë 12 muajve të fundit.




Figura 8. Si keni ndërvepruar me komunën tuaj gjatë 12 muajve të fundit (përveçse gjatë fushatave zgjedhore)?

Nëse i zbërthejmë rezultatet e anketës sipas gjinisë, vërejmë se më shumë gra (78%) sesa burra (69%) nuk kanë pasur kurrfarë ndërveprimi me komunën e tyre gjatë 12 muajve të fundit. Në përgjithësi, grafiku i mëposhtëm tregon se burrat kanë ndërvepruar më shumë me komunën e tyre.




Figura 9. Si keni ndërvepruar me komunën tuaj gjatë 12 muajve të fundit (përveçse gjatë fushatave zgjedhore)? Zbërthimi sipas gjinisë

Duke qenë se të dhënat sasiore tregojnë se shumica e të anketuarve (76%) nuk kanë pasur kurrfarë ndërveprimi me komunat e tyre gjatë 12 muajve të fundit, komponenti cilësor i studimit i ka kushtuar vëmendje zbulimit të shkaqeve për këtë të fundit. Një nga faktorët kryesorë që kontribuon në nivelet e ulëta të ndërveprimit me komunën duket se janë radhët e gjata që qytetarët duhet të presin për t'iu qasur zyrtarëve komunalë. Pjesëmarrësit në studim kanë deklaruar se zyrtarët komunal nuk e respektojnë orarin e tyre të punës dhe nuk i kryejnë detyrat e tyre në përputhje me rrethanat. Sipas tyre, zyrtarët komunalë priren të mos respektojnë orarin e tyre të punës dhe marrin pushime të zgjatura për kafe, gjë që në thelb shkakton krijimin e radhëve të gjata të qytetarëve që presin për të marrë shërbime. Rrjedhimisht, kjo i bën qytetarët që të mos e kenë besimin e plotë në komunat e tyre.



Përveç kësaj, pjesëmarrësit janë shprehur gjithashtu se ka mungesë të përfaqësimit të të rinjve në komunë. Ata kanë deklaruar se dëgjimet publike zakonisht kanë për synim grupmoshat më të vjetra, gjë që si pasojë përjashton pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen komunale.

Në pyetjen rreth rekomandimeve të tyre për rritjen e ndërveprimit midis komunave dhe qytetarëve, studimi aktual ka identifikuar pikëpamje mjaft homogjene. Në përgjithësi, pjesëmarrësit besojnë se komuna duhet të aplikojë rregulla më të rrepta për punonjësit e tyre për të përmbushur detyrat e tyre ndaj qytetarëve. Rekomandimet e tjera përfshijnë informimin më të gjerësishëm rreth dëgjimeve publike, si dhe përfshirje të shtuar të të gjithë banorëve të komunës. Sipas tyre, kjo e fundit mund të arrihet përmes zgjedhjes së një përfaqësuesi të lagjes i/e cili/cila do të përfaqësonte nevojat e qytetarëve të të gjitha komuniteteve gjatë dëgjimeve publike komunale.

Të anketuarit që kanë ndërvepruar me komunat e tyre gjatë 12 muajve të fundit, janë pyetur më tej rreth çështjeve që i kanë ngritur në komuna. Bazuar në rezultatet e marra, 53% e të anketuarve kanë ngritur çështje rreth infrastrukturës lokale, pasuar nga ata që kanë ngritur çështje rreth mjedisit (47%) ose arsimit (45%). Një pjesë më e vogël e të anketuarve kanë ngritur çështje rreth shëndetësisë (35%) dhe sigurisë publike (34%). Përveç kësaj, 24% e qytetarëve të anketuar kanë ngritur çështje të lidhura me aktivitetet kulturore/rekreative apo të trafikut (23%). Dhe në fund, 15% e të anketuarve kanë raportuar se kanë ngritur çështje që lidhen me gratë ose grupet e marginalizuara.

Gjatë zbërthimit të rezultateve sipas komunave, vërejmë se të gjithë të anketuarit (100%) nga Deçani kanë ngritur çështjen e infrastrukturës lokale. Shumica e qytetarëve të anketuar nga Skenderaj kanë ngritur çështje si arsimit (91%), shëndetësia (91%) dhe siguria publike (83%). Në anën tjetër, shumica e të anketuarve (87%) nga Suhareka kanë ngritur çështjet mjedisore, aktivitetet kulturore/rekreative dhe problemet e trafikut.




Figura 10. Çfarë çështje keni ngritur pranë komunës?

Rezultatet tregojnë se më shumë gra (18%) sesa burra (13%) kanë ngritur çështje që lidhen me gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara të shoqërisë. Gratë gjithashtu kanë më shumë gjasa se burrat të ngritin çështje në lidhje me mjedisin, arsimin dhe shëndetësinë. Megjithatë, 56% e burrave pretendojnë se kanë ngritur çështje në lidhje me infrastrukturën lokale, krahasuar me 48% të grave që kanë bërë të njëjtën gjë.




Figura 11. Çfarë çështje keni ngritur pranë komunës? Zbërthimi sipas gjinisë

Në përpjekje për të pas një ide më të mirë se si angazhohen komunat me qytetarët, të anketuarit janë pyetur lidhur me procesin e dëgjimit publik. Siç tregon grafiku i më poshtëm, më shumë se gjysma e të anketuarve (58%) janë të informuar vetëm për atë që do të ndodhë ose që tashmë ka ndodhur gjatë takimeve publike, ndërsa 32% e tyre kanë deklaruar se komuna ofron opsione të ndryshme dhe kërkon komente/mendime nga ta. Dhe në fund, vetëm 10% e të anketuarve kanë deklaruar se komuna kërkon komente/mendime të hapura.

Të gjithë të anketuarit (100%) nga Graçanica kanë deklaruar se janë të informuar për atë që ndodh vetëm pasi të ketë ndodhur, krahasuar me të gjithë qytetarët e anketuar nga Hani i Elezit të cilët kanë deklaruar se komuna e tyre ofron mundësi të ndryshme dhe kërkon komente/mendime, dhe të gjithë të anketuarit nga Leposaviqi pohojnë se komuna e tyre kërkon komente/mendime të hapura (pa ofruar opsione).




Figura 12. Si ju angazhon komuna gjatë takimeve publike?



Për më tepër, shumica e të anketuarve (74%) pajtohen/pajtohen plotësisht që autoritetet komunale të marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike, ndërsa 24% e të anketuarve nuk pajtohen/nuk pajtohen plotësisht me deklarin e sipërpërmendur.

Të dhënat tregojnë se të gjithë të anketuarit nga komuna e Gjakovës, Glllogovcit, Hanit të Elezit, Klinës, Leposaviqit, Malishevës, Parteshit, Rahovecit, Ranillugut, Suharekës dhe Vitisë pajtohen plotësisht/pajtohen që autoritetet komunale marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike. Në anën tjetër, të gjithë të anketuarit nga Shtërpca nuk pajtohen fare/nuk pajtohen me këtë deklarin.




Figura 13. Deri në çfarë mase pajtoheni se autoritetet komunale i marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike?

Gjatë matjes së nivelit në të cilën komunat marrin pjesë në sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike, të dhënat cilësore sugjerojnë se komunat nuk i marrin parasysh sugjerimet e qytetarëve. Për më tepër, duket se ka një pjesëmarrje të njëanshme politike në seancat dëgjimore publike. Sipas tyre, në këto takime publike zakonisht marrin pjesë përkrasit e një partie të caktuar. Prandaj, kjo bën që rrallë të merret një vendim përmbajtësor dhe i favorshëm.

“Ata nuk i marrin parasysh sugjerimet tona. Së fundi e kanë shtruar rrugën dhe nuk i kanë marrë parasysh sugjerimet tona, ne iu patëm thënë ta zgjerojnë edhe për një metër, por nuk na kanë dëgjuar.”

- Pjesëmarrës nga diskutimi i fokus grupit serb

Të anketuarit të cilët kanë deklaruar se kanë ngritur ndonjë problem tek komuna e tyre, janë pyetur gjithashtu nëse kjo e fundit iu është përgjigjur për çështjet e ngritura. Sipas rezultateve të studimit, shumica e të anketuarve (83%) deklaruan se komuna nuk iu është përgjigjur çështjeve që ata kishin ngritur. Ndryshe nga këta të fundit, 17 për qind e të anketuarve pohuan se komuna iu është përgjigjur kërkesave të tyre.

Shumica e të anketuarve nga Peja (88%), Kaçaniku (83%), Klina (80%) dhe Deçani (75%) pohuan se komuna e tyre iu është përgjigjur atyre kur ata kishin ngritur një çështje. Ndryshe nga këta të fundit, të gjithë të anketuarit nga komunat e Graçanicës, Leposaviqit, Malishevës, Mitrovicës së Veriut, Shtërpçës dhe Zveçanit, të cilët kishin ngritur një çështje në komunë, pohuan se nuk ishin marrë përgjigje.




Figura 14. Nëse keni ngritur një çështje, a iu është përgjigjur komuna për çështjen që e keni ngritur?

Të anketuarit u pyetën gjithashtu për kohën që iu desh komunave për t'iu dhënë përgjigje ndaj çështjeve që ata kishin ngritur. Të dhënat tregojnë se komunës i duhen mesatarisht 17 ditë për tu përgjigjur në një çështje. Megjithatë, sipas rezultateve, grave iu duhen 19 ditë për të pranuar një përgjigje, ndërsa kohëzgjatje mesatare për përgjigje ndaj burrave të anketuar ishte 15 ditë.



Figura 15. Nëse po, sa ditë iu deshën komunës për t'iu përgjigjur çështjes që kishit ngritur? Ndarja gjinore

Grafiku i mëposhtëm tregon se më shumë se gjysma e të anketuarve (60%) janë deri diku/plotësisht të kënaqur me përgjigjen e komunës ndaj çështjes që ata kishin ngritur. Megjithatë, 27 për qind sosh janë deri diku/nuk janë aspak të kënaqur me përgjigjen e komunës. Në fund, 12 për qind e të anketuarve nuk kanë asnjë mendim ose kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Rreth 97 për qind e të anketuarve nga Suhareka ishin të kënaqur me përgjigjen që morën, ndërsa përqindja e njëjtë (81%) e të anketuarve nga Novobërda dhe Shtërpca deklaruan të kundërtën.




Figura 16. Sa të kënaqur ishit me reagimin e komunës për çështjen që kishit ngritur?



Kur u vlerësua gatishmëria e të anketuarve në anketë për të përdorur platforma digjitale për t'u angazhuar me komunat e tyre, më shumë se gjysma e të anketuarve (62%) ishin të gatshëm për ta bërë këtë, ndërsa 38 për qind e tyre deklaruan të kundërtën. Të dhënat tregojnë se burrat (66%) janë më të gatshëm sesa gratë (58%) për të përdorur platformat digjitale për t'u angazhuar me komunën e tyre.

Shumica dërrmuese e të anketuarve nga Skenderaj (95%), Suhareka (93%) dhe Mitrovica e Jugut (90%) pohuan se do të ishin të gatshëm për të përdorur platforma digjitale për t'u angazhuar me komunën e tyre. Në anën tjetër, të gjithë të anketuarit nga Leposaviqi pohuan se nuk do të ishin të gatshëm për të përdorur platformat digjitale për t'u angazhuar me komunën.




Figura 17. A do të ishit të gatshëm për të përdorur platformat digjitale për t'u angazhuar me komunën tuaj?

Tutje, të anketuarit u pyetën nëse kanë informata se si ndahet buxheti komunal. Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, vetëm 23 për qind e të anketuarve ishin në dijeni se si ndahet/shpërndahet buxheti komunal, ndërsa shumica e tyre (77%) nuk e kanë këtë informatë. Rezultatet e studimit tregojnë se burrat janë paksa më të informuar (25%) sesa gratë (23%) se si ndahet buxheti komunal.

Të anketuarit nga Prishtina janë më të informuarit për mënyrën e ndarjes së buxhetit komunal (48%), të pasuar nga të anketuarit nga Fushë Kosova (40%) dhe Mitrovica e Jugut (38%). Të anketuarit nga Hani i Elezit dhe Zubin Potoku nuk janë fare të informuar për shpërndarjen e buxhetit të komunës së tyre.




Figura 18. A keni informata se si ndahet buxheti i komunës?

Lidhur me faktorët që ndikojnë në mungesën e informatave tek qytetarët për shpërndarjen e buxhetit komunal, diskutimet në fokus grupe me qytetarët dalluan dy arsye kryesore. Përgjigjet që dolën nga analiza e të dhënave sugjerojnë se i konvenon organeve komunale që t'i mbajnë qytetarët të painformuar për buxhetin. Kësisoj, atyre u lejohet të ndajnë buxhetin ashtu si iu përshtatet atyre dhe jo qytetarëve. Arsyeja e dytë e mungesës së informatave tek qytetarët për buxhetin komunal është thjesht mungesa e interesimit të qytetarëve për këto çështje.

Pjesëmarrësit në fokus grup gjithashtu dhanë rekomandimet e tyre për përmirësimin e situatës në lidhje me boshllëqet e informatave për buxhetin komunal. Pjesëmarrësit besojnë se komunikimi i informatave duhet të bëhet përmes platformave të mediave sociale, faqes zyrtare të komunës, pamfleteve, Radiotelevizionit dhe/ose përmes emërimit të përfaqësuesve të lagjeve që do të veprojnë si ndërmjetësues të komunikimit për informim më të mirë të qytetarëve.

Të anketuarit të cilët ishin në dijeni se si ndahet/shpërndahet buxheti komunal, u pyetën gjithashtu për nivelin e tyre të kënaqshmërisë me përcaktimin e prioriteteve të projekteve në buxhetin komunal. Shumica e të anketuarve (78%) ishin të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve në buxhetin komunal. Nga ana tjetër, 19 për qind raportuan se ishin deri diku të pakënaqur me përcaktimin e prioriteteve të projekteve dhe tre për qind nuk janë aspak të kënaqur.

Ekziston një nivel i lartë i kënaqshmërisë (100%) tek të anketuarit në Graçanicë, Junik, Kllokot, Mamushë, Partesh, Ranillug, Skenderaj dhe Suharekë për priorizimin që komuna e tyre ia ka bërë projekteve. Në anën tjetër, të gjithë të anketuarit nga Novobërda dhe Shtërpca janë të pakënaqur me përcaktimin e prioriteteve në buxhetin komunal.




Figura 19. Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve të projekteve në buxhetin komunal?

Gjatë zbërthimit të rezultateve të pyetjes së lartpërmendur në aspektin gjinor, vërejmë se gratë (79%) janë paksa më të kënaqura se burrat (76%) me përcaktimin e prioriteteve të projekteve në buxhetin komunal.




Figure 20. Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve të projekteve në buxhetin komunal? Ndarja gjinore

Roli i Kuvendit të Komunës

Ky seksion i raportit ka për qëllim të ofrojë informata lidhur me dijeninë dhe opinionet e qytetarëve kosovarë për Kuvendin e Komunës, angazhimin e tyre në seancat e KK-së, si dhe arsyet që e bëjnë këtë.

Të anketuarit në anketë u pyetën për shkallën e dijenisë së tyre për rolin dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të komunës. Grafiku i mëposhtëm tregon se 41 për qind e të anketuarve janë mesatarisht në dijeni për rolin dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të komunës, dhe një numër më i vogël i të anketuarve (31%) janë pak në dijeni për këtë. Të dhënat tregojnë se dhjetë për qind e qytetarëve të anketuar nuk janë fare në dijeni për rolin dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të komunës. Megjithatë, 15 për qind e të anketuarve janë plotësisht në dijeni për rolet dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të komunës.

Të anketuarit të cilët kanë nivelin më të lartë të dijenisë për rolin dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të tyre të komunës janë ata nga Suhareka (93%), të pasuar nga Klina (91%) dhe Parteshi (85%). Në anën tjetër, 61 për qind e të anketuarve të Novobërdës nuk janë aspak të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të komunës.




Figura 21. Deri në çfarë shkalle jeni në dijeni për rolin dhe përgjegjësitë e asambleistëve të kuvendit të komunës?

Shumica e qytetarëve të anketuar (71%) nuk janë takuar me asnjë asambleist të kuvendit të komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar për çështje të përbashkëta publike. Gjatë ndarjes së rezultateve në aspektin e komunës, vërejmë se asnjë i anketuar nga Zubin Potoku nuk ka deklaruar se është takuar me një asambleist të Kuvendit të Komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të tilla. Megjithatë, 71 për qind e të anketuarve nga Suhareka deklaruan të kundërtën, të pasuar nga 57 për qind sosh nga Parteshi dhe 48 për qind sosh nga Ranillugu dhe Istogu që janë takuar me një asambleist të kuvendit të komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike.




Figura 22. A keni takuar ndonjë asambleist të kuvendit të komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike?

Kur ndajmë rezultatet e studimit për nga aspekti gjinor, vërejmë se më shumë burra (35%) sesa gra (23%) janë takuar me një asambleist të Kuvendit të Komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike.




Figura 23. A keni takuar ndonjë asambleist të kuvendit të komunës në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike? Ndarja gjinore

Shumica e të anketuarve (87%) thanë se nuk kanë marrë pjesë në asnjë seancë të Kuvendit të Komunës në 12 muajt e fundit. Kur u ndanë sipas komunave, të gjithë të anketuarit nga Hani i Elezit, Novobërda, Zubin Potoku dhe Zveçani deklaruan se nuk kanë marrë pjesë në asnjë seancë të Kuvendit të Komunës në 12 muajt e fundit. Në anën tjetër, 41 për qind e të anketuarve nga Istogu pohuan se kishin marrë pjesë në seanca të tilla gjatë vitit të kaluar, nga 36 për qind e të anketuarve nga Parteshi që deklaruan të njëjtën gjë.




Figura 24. A keni marrë pjesë në ndonjë seancë të Kuvendit të Komunës në 12 muajt e fundit?

Kur u shtjelluan arsyet përse të anketuarit nuk kanë marrë pjesë në asnjë seancë të Kuvendit të Komunës, 43 për qind deklaruan se nuk janë të interesuar, të pasuar nga 37 për qind sosh që nuk janë të informuar dhe 20 për qind sosh thanë se ishin të zënë.

Shumica e të anketuarve nga Kaçaniku (94%) thanë se nuk ishin të interesuar, që pasohet nga 78 për qind e të anketuarve nga Deçani që thanë të njëjtën gjë. Të gjithë të anketuarit nga Novobërda (100%) thanë se nuk ishin të informuar për ngjarje të tilla, ndërsa 67 për qind e të anketuarve nga Zubin Potok nuk morën pjesë në ngjarje të tilla sepse ishin të zënë.




Figura 25. Cila është arsyeja?

Grafiku më poshtë tregon se 37 për qind e të anketuarve i kanë ndjekur seancat e kuvendit komunal përmes mediave të ndryshme. Nga ana tjetër, gjashtëdhjetë e tre për qind e tyre deklaruan se nuk i kanë ndjekur ato seanca.

Të gjithë të anketuarit nga Zubin Potok, 97 për qind e të anketuarve nga Kaçaniku dhe 92 për qind e atyre nga Kllokoti dhe Ranillugu nuk i kanë ndjekur seancat e Kuvendit Komunal përmes mediave. Përkundrazi, 69 për qind e të anketuarve nga Prishtina dhe 53 për qind e atyre nga Dragashi thonë se i kanë ndjekur seancat e Kuvendit Komunal përmes mediave.




Figura 26. A i keni ndjekur seancat e kuvendit komunal përmes mediave (TV/radio/media sociale)?

Grafiku i mëposhtëm tregon se shumica e qytetarëve të anketuar (71%) pajtohen/plotësisht pajtohen që Kuvendi Komunal arrin ta mbajë ekzekutivin përgjegjës, ndërsa një në katër të anketuar (25%) nuk pajtohen/nuk pajtohen fare me këtë konstatim.

Shumica dërrmuese e të anketuarve nga Suhareka (98%) pajtohen/plotësisht pajtohen se Kuvendi Komunal arrin të mbajë ekzekutivin përgjegjës. Për më tepër, 94 për qind e qytetarëve të anketuar nga Malisheva dhe 93 për qind e atyre nga Peja mendojnë të njëjtën gjë. Rreth 87 për qind e të anketuarve nga Novobërda mendojnë se Kuvendi Komunal po dështon ta mbajë ekzekutivin përgjegjës, pasuar nga 77 për qind e të anketuarve nga Shtërpca që mendojnë të njëjtën gjë.




Figura 27. Deri në çfarë mase pajtoheni që Kuvendi Komunal arrin të mbajë përgjegjësi ekzekutive (kryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale)?

Menaxhimi komunal

Ky seksion paraqet të dhënat cilësore dhe sasiore të mbledhura nëpër të gjitha komunat e Kosovës në lidhje me mendimet e qytetarëve për menaxhimin komunal. Të anketuarit ndajnë nivelin e tyre të kënaqësisë me menaxhimin e buxhetit komunal, projektet e infrastrukturës publike, si dhe mendimet e tyre rreth procesit të rekrutimit në komuna.

Grafiku më poshtë paraqet kënaqësinë e të anketuarve me menaxhimin e buxhetit komunal. Më shumë se gjysma e të anketuarve (56%) janë disi të kënaqur me këtë, ndërsa vetëm 11 për qind janë plotësisht të kënaqur. Megjithatë, 21 për qind janë disi të pakënaqur dhe shtatë për qind nuk janë aspak të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal.

Rreth 93 për qind e të anketuarve nga Suhareka janë disi të kënaqur/plotësisht të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal, pasuar nga pjesa e njëjtë e atyre nga Kaçaniku dhe Parteshi që mendojnë të njëjtën gjë (92%). Në anën tjetër, niveli i pakënaqësisë është më i lartë në mesin e të anketuarve nga Novobërda (90%) dhe Shtërpca (86%).




Figura 28. Sa jeni të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal?

Të dhënat cilësore më tej tregojnë se pakënaqësia e qytetarëve me menaxhimin e buxhetit komunal më së shumti buron nga çështjet e punësimit. Qytetarët besojnë se komuna duhet të ndajë më shumë fonde për projekte/ programe që mund të rrisin shanset e qytetarëve për të arritur punësim. Çështje të tjera të listuara që pjesëmarrësit mendojnë se janë prioritare përfshijnë qasjen në ujë të pijshëm, nevojën për hapësira të gjelbra, çështjet e infrastrukturës, objektet e shëndetit mendor, materialet e ndërtimit, planifikimin urban, etj.

Rezultatet e anketës tregojnë se 69 për qind e qytetarëve të anketuar janë plotësisht/disi të kënaqur me cilësinë e punës në projektet infrastrukturore në komunat e tyre, ndërsa 30 për qind janë disi të pakënaqur/fare pak të kënaqur. Për më tepër, 65 për qind e të anketuarve janë disi/plotësisht të kënaqur me kohëzgjatjen e punës në projektet e infrastrukturës publike. Përkundrazi, 33 për qind e të anketuarve janë disi të pakënaqur/nuk janë aspak të kënaqur me kohën që i duhet komunës për të përfunduar projektet/punimet infrastrukturore publike në zonën e tyre.

Shumica dërrmuese e të anketuarve nga Suhareka (98%) thanë se ishin plotësisht/disi të kënaqur me cilësinë e projekteve publike infrastrukturore në komunën e tyre, pasuar nga 97 për qind e të anketuarve nga Kaçaniku që ndihen njëjtë. Për më tepër, pjesë e njëjtë e të anketuarve (95%) nga komuna e Deçanit dhe Ferizajt janë të kënaqur me cilësinë e punës në infrastrukturën publike të komunës së tyre. Përkundrazi, të anketuarit nga komuna e Leposaviçit (82%), Mitrovica e Veriut (81%) dhe Shtërpca (73%) ishin disi të pakënaqur/nuk ishin aspak të kënaqur me cilësinë e punës në lidhje me projektet e infrastrukturës publike.

Kur shikojmë nivelin e kënaqësisë në lidhje me kohëzgjatjen e punës në komuna të ndryshme anembanë Kosovës, vërejmë se shumica dërrmuese e të anketuarve nga Kaçaniku (98%) thanë se ishin disi /plotësisht të kënaqur. Të anketuarit nga Suhareka (95%), Parteshi (92%) dhe Peja (92%) janë gjithashtu të kënaqur me kohën që i duhet komunës për të përfunduar projektet/punimet infrastrukturore publike. Në anën tjetër, të anketuarit nga Shtërpca (93%), Novobërda (74%) dhe Graçanica (68%) nuk janë aspak të kënaqur/disi të pakënaqur me kohëzgjatjen e punës së bërë në projektet e infrastrukturës publike.




Figura 29. Sa jeni të kënaqur me projektet/punimet e infrastrukturës publike në komunën tuaj?

Gjatë vlerësimit të kriterëve që merren parasysh gjatë procesit të rekrutimit të punëtorëve në komunë, të anketuarit kanë mendime të ndryshme. Bazuar në rezultatet, 64 për qind e tyre besojnë se përkatësia politike është faktori më i rëndësishëm që merret parasysh gjatë rekrutimit të punëtorëve në komunë, e pasuar nga lidhjet familjare (54%). Megjithatë, disa të anketuar besojnë se arsimi (44%) dhe përvoja e punës (43%) janë faktorët më të rëndësishëm që merren parasysh gjatë punësimit të punëtorëve në komunë.



Sipas 88 për qind të të anketuarve nga Suhareka, niveli arsimor është kriteri kryesor gjatë procesit të rekrutimit të punëtorëve në komunë, pasuar nga përqindja e njëjtë e të anketuarve nga Kaçaniku dhe Parteshi që mendojnë të njëjtën gjë (85%). Të dhënat tregojnë se 68 për qind e të anketuarve nga Skenderaj, 66 për qind e atyre nga Kaçaniku dhe 64 për qind e të anketuarve nga Klina mendojnë se përvoja e punës është kriteri kryesor gjatë rekrutimit të punëtorëve në komunë. Në anën tjetër, të gjithë të anketuarit nga Malisheva mendojnë se përkatësia politike dhe lidhjet familjare janë marrë më së shumti parasysh gjatë procesit të rekrutimit në komunë. Për më tepër, shumica dërrmuese e të anketuarve nga Parteshi (91%), Prizreni (89%) dhe Suhareka (88%) mendojnë se përkatësia politike merret parasysh gjatë rekrutimit të punëtorëve në komunën e tyre. Rreth 82 për qind e të anketuarve nga Parteshi, dhe e njëjta përqindje e të anketuarve nga Hani i Elezit dhe Mamusha (80%) mendojnë se lidhjet familjare janë të rëndësishme në procesin e rekrutimit.




Figura 30. Sipas jush, cilat kriterere merren parasysh gjatë procesit të rekrutimit të punëtorëve në komunë?

Përgjigjet e marra nga diskutimet e fokus grupeve mbështesin më tej konstatimin se përkatësia politike është faktori më i rëndësishëm që merret parasysh gjatë rekrutimit të punonjësve në komunë. Ata besojnë se kjo e fundit është kthyer në traditë në Kosovë dhe vetëm sa është duke u rritur si fenomen ndër vite. Megjithatë, ata besojnë se në vitet e fundit situata është bërë gjithnjë e më e rëndë. Pjesëmarrësit shpjeguan se edhe qytetarët duhet të mbahen përgjegjës për përfshirjen e vazhdueshme të këtij fenomeni duke bashkëpunuar aktivisht me autorët në marrjen e veprimeve të korrupsionit. Ata në mënyrë alternative vazhduan të ofrojnë historitë e tyre të privimit nga ndonjë mundësi pune për shkak të akteve të nepotizmit:

“Kam pasur rastin që kam aplikuar në administratën tatimore, kur kam aplikuar më kanë thënë që duhet të jap 5 mijë euro për të gjetur punë. Kur dolën rezultatet, pashë që në listë nuk ishte emri im, por një person që ishte më pak i përgatitur se unë. Ai person u punësua sepse i dha shumën e kërkuar të parave.”

“Deri më tani kam aplikuar në shtatë vende pune në komunë dhe asnjëherë nuk kam marrë përgjigje edhe pse mendoj se kam qenë kandidati më i përgatitur në fushën e arkitekturës”.

“Kanë hapur vetëm formalisht konkurse të tjera, dhe kush përzgjidhet, mendoj se ndikon shumë orientimi politik”.

-

- Pjesëmarrësit nga diskutimet e fokus grupeve

Pjesëmarrësve të pranishëm në diskutimin e fokus grupeve iu kërkua më tej të zbulojnë mendimin e tyre se çfarë mund të bëhet për të siguruar një proces të drejtë në rekrutimin e stafit komunal. Pjesëmarrësit besojnë se duhet të sigurohen mekanizma më të fortë në monitorimin e procesit të rekrutimit përmes burimeve të jashtme ose nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile. Për më tepër, ata janë të mendimit se edhe Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit duhet të forcohet në mënyrë që ata të përmbushin në mënyrë adekuate rolin e tyre. Rekomandimet tjera përfshinin sigurimin e një karte sociale për të gjithë qytetarët e Kosovës në mënyrë që punëdhënësit të mund të ndërjegjësohen për statusin social të punëtorëve të tyre.

Për më tepër, të anketuarit u pyetën nëse konsiderojnë se komunat e tyre ofrojnë mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse për gratë. Më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) besojnë se komuna e tyre ofron deri diku mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse për gratë, ndërsa vetëm 13 për qind besojnë se këto mundësi ofrohen në masë të madhe. Megjithatë, 24 për qind e të anketuarve besojnë se grave u ofrohen shumë pak mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse. Përveç kësaj, shtatë për qind e tyre besojnë se komunat e tyre nuk ofrojnë fare mundësi të barabarta për gratë në pozita udhëheqëse. Kur analizojmë rezultatet e kësaj pyetjeje në aspektin gjinor, nuk vërehen dallime në përgjigjet e dhëna nga burrat dhe gratë.

Shumica e të anketuarve nga Suhareka (95%) mendojnë se komuna e tyre u ofron grave mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse. Njëjtë mendojnë 92 për qind e të anketuarve nga Parteshi dhe 89 për qind e atyre nga Malisheva. Në anën tjetër, 45 për qind e qytetarëve të anketuar nga Novobërda thanë se komuna nuk u ofron grave fare mundësi të barabarta, pasuar nga të anketuarit nga Shtërpca (42%) dhe Klina (40%) të cilët deklaruan të njëjtën gjë.




Figura 31. A mendoni se komuna juaj u ofron grave mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse (arsim, shëndetësi, institucione kulturore dhe pozita politike në komunë)

Të dhënat cilësore në studim tentojnë të njohin arsyen themelore të mundësive të pabarabarta që u ofrohen grave në ushtrimin e pozitave udhëheqëse në arsim, shëndetësi, institucionet e kulturës dhe pozitat politike në komunë. Përgjigjet e marra sugjerojnë se stereotipet dhe paragjykimet për rolin e gruas mbeten të rrënjosura thellë në shoqërinë kosovare. Në përgjithësi, duket se gratë nuk përcillen si kompetente për të kryer role udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Edhe gratë që tashmë janë në pozita udhëheqëse nuk marrin përsipër përgjegjësinë e plotë në marrjen e vendimeve të rëndësishme të pavarura nga ndikimi i burrave. Prandaj, pjesëmarrësit besojnë se komunat rekrutojnë gra më së shumti për shkak të detyrimit të tyre ndaj kuotës, siç



kërkohet me ligj, sesa për shkak të ekspertizës së tyre. Megjithatë, pjesëmarrësit mbeten te ajo se situata është përmirësuar me kalimin e viteve dhe pritet të përmirësohet më tej në të ardhmen.

Ofrimi i shërbimeve

Kjo pjesë e raportit do të prezantojë gjetjet e studimit për shërbimet komunale që i përdorin qytetarët e Kosovës, si dhe kënaqshmërinë e tyre me shërbime të tilla.

Të anketuarit u pyetën nëse i kanë shfrytëzuar shërbimet komunale, si shërbimet administrative, lejet e ndërtimit, shërbimet parësore shëndetësore, transportin publik, arsimin parauniversitar (për vete ose anëtarët e ngushtë të familjes) dhe hapësirat publike (parqet, teatrot, fushat sportive, etj.) gjatë 12 muajve të fundit. Shumica dërrmuese e të anketuarve (85%) deklaruan se kanë shfrytëzuar lejet e ndërtimit në 12 muajt e kaluar, të pasuar nga 77 për qind e tyre që deklaruan se kanë shfrytëzuar shërbimet administrative. Më tej, shumica e tyre kanë shfrytëzuar shërbimet parësore shëndetësore (69%) dhe shërbimet e transportit publik (60%). Një numër pak më i vogël i tyre kanë shfrytëzuar hapësirat publike (49%) dhe shërbimet e arsimit parauniversitar (47%).

Kur ndahen sipas komunave, të gjithë të anketuarit nga Mamusha dhe Malisheva kanë shfrytëzuar shërbimet administrative në 12 muajt e fundit, krahasuar me 88 për qind të të anketuarve nga Zveçani që u shprehën se nuk i kanë shfrytëzuar. Shumica e të anketuarve nga Malisheva (100%), pasuar nga Kaçaniku (99%), Klina (99%) dhe Peja (98%) deklaruan se nuk i kanë përdorur shërbimet e lejeve të ndërtimit. Në anën tjetër, të anketuarit që kanë shfrytëzuar më shumë shërbimet e lejeve të ndërtimit ishin nga Dragashi (39%), Fushë Kosova (36%) dhe Shtërpca (36%). Të dhënat tregojnë se të gjithë të anketuarit nga komuna e Malishevës dhe Mamushës kanë shfrytëzuar shërbimet parësore shëndetësore në 12 muajt e fundit, ndërsa 97 për qind e të anketuarve nga Klina nuk i kanë përdorur ato. Shumica e të anketuarve nga Suhareka (89%) kanë shfrytëzuar transportin publik në 12 muajt e fundit, krahasuar me pothuajse të gjithë të anketuarit nga Klina (99%) që nuk e kanë shfrytëzuar atë. Gjithashtu, 99 për qind e qytetarëve të anketuar nga Klina kanë shfrytëzuar arsimin parauniversitar (për vete ose për ndonjë anëtar të ngushtë të familjes) gjatë vitit të kaluar. Në fund, hapësirat publike janë shfrytëzuar më së shumti nga të anketuarit nga komunat e Malishevës (99%), Suharekës (97%) dhe Mamushës (93%).




Figura 32. A keni përdorur shërbimet komunale të mëposhtme në 12 muajt e fundit?

Për më tepër, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin nivelin e tyre të kënaqshmërisë me shërbimet e mëposhtme komunale, si, shërbimet administrative, shërbimet shëndetësore, transportin publik, arsimin parauniversitar, hapësirat publike (parqet, teatrot, fushat sportive, etj.) dhe infrastrukturën rrugore (rrugët lokale dhe trotuaret).

Shumica dërmuese e të anketuarve (81%) janë të kënaqur me shërbimet administrative të ofruara nga komuna e tyre, pasuar nga 68 për qind e të anketuarve që janë disi/plotësisht të kënaqur me shërbimet shëndetësore të komunës së tyre dhe 66 për qind e të anketuarve janë disi/plotësisht të kënaqur me transportin publik të komunës së tyre. Më tej, 22 për qind e të anketuarve janë disi të pakënaqur/aspak të kënaqur me arsimin parauniversitar, pasuar nga 17 për qind e tyre që janë disi të pakënaqur me hapësirat publike. Së fundi, shumica e të anketuarve (71%) janë të kënaqur me infrastrukturën rrugore, ndërsa 17 për qind janë disi të pakënaqur me të.

Të dhënat tregojnë se të gjithë të anketuarit nga Mamusha, Parteshi dhe Suhareka janë të kënaqur me shërbimet administrative të ofruara në komunën e tyre. Nivele të kënaqshme janë paraqitur edhe te të anketuarit nga Malisheva (98%), Hani i Elezit (97%) dhe Gjakova (96%). Megjithatë, shumica dërmuese e qytetarëve të anketuar nga Mitrovica e Veriut (90%) dhe Leposaviqi (88%) janë të pakënaqur me shërbimet administrative në komunën e tyre. Mamusha, Parteshi dhe Suhareka janë të kënaqur me shërbimet shëndetësore në komunën e tyre, krahasuar me 88 për qind të të anketuarve nga Mitrovica e Veriut dhe 84 për qind të të anketuarve nga Leposaviqi të cilët janë të pakënaqur me shërbimet e tilla. Më tej, niveli i kënaqshmërisë në lidhje me transportin publik është mjaft i lartë në mesin e të anketuarve nga Kaçaniku (97%), Suhareka (94%) dhe Parteshi (92%). Megjithatë, shumica e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut (91%), Leposaviqi (81%) dhe Malisheva (66%) nuk janë të kënaqur me sistemin e transportit publik në komunën e tyre. Sipas rezultateve të anketës, të gjithë të anketuarit nga Mamusha dhe Parteshi janë të kënaqur me shërbimet e arsimit parauniversitar që ofron komuna e tyre. Përveç kësaj, niveli i kënaqshmërisë në lidhje me hapësirat publike është më i lartë në Partesh dhe Suharekë (100%). Së fundi, të gjithë të anketuarit nga Parteshi dhe shumica dërmuese e të anketuarve nga Kaçaniku (98%), Suhareka (97%) dhe Deçani (95%) janë të kënaqur me infrastrukturën rrugore në komunën e tyre. Përkundrazi, të anketuarit nga Mitrovica e Veriut kanë deklaruar të kundërtën (86%).




Figura 33. Ju lutemi vlerësoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me shërbimin e mëposhtëm komunal



Të dhënat cilësore të përfituara sugjerojnë se pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupeve ishin të angazhuar kryesisht në marrjen e shërbimeve administrative si, dokumentet tatimore, dokumentet e identifikimit, dokumentet e regjistrimit dhe legalizimit të pronës etj. Kur u pyetën për nivelet e kënaqshmërisë me shërbimet komunale, përgjigjet ndër pjesëmarrësit përgjithësisht sugjerojnë një shkallë të lartë kënaqshmërie. Pjesëmarrësit deklaruan se shërbimet janë marrë në kohën e duhur dhe shërbimet janë ofruar në mënyrë profesionale.

Bazuar në rezultatet e anketës, 69 për qind e të anketuarve janë deri diku të kënaqur/plotësisht të kënaqur me planifikimin hapësinor në komunat e tyre. Megjithatë, 21 për qind e tyre janë disi të pakënaqur dhe pesë për qind nuk janë aspak të kënaqur me këto shërbime.

Kur i zbërthejmë rezultatet sipas komunave, vërehet se rreth 98 për qind e të anketuarve nga Suhareka kanë thënë se janë të kënaqur me planifikimin hapësinor në komunën e tyre. E njëjta përqindje e të anketuarve nga Kaçaniku dhe Peja (95%) janë gjithashtu të kënaqur. Tetëdhjetë e katër për qind e të anketuarve nga Novobërda janë të pakënaqur me planifikimin hapësinor, të pasuar nga të anketuarit nga Shtërpca (82%) dhe pjesa e njëjtë e atyre nga Graçanica dhe Istogu (65%).




Figura 34. Sa jeni të kënaqur me planifikimin hapësinor (zhvillimi komunal dhe planifikimi i përdorimit të tokës)?

Qytetarët që morën pjesë në diskutimin në fokus grup deklarojnë se nuk janë mjaft të kënaqur me planifikimin hapësinor (zhvillimi komunal dhe planifikimi i shfrytëzimit të tokës). Ata u shprehën se rrallëherë janë të informuar për planifikimin e projekteve dhe zakonisht kuptojnë për këto projekte tek pas fillimit të tyre. Pjesëmarrësit nga diskutimi i fokus grupeve të burrave u shprehën të jenë veçanërisht të pakënaqur me faktin se shumica e ndërtesave në komunën e tyre ende nuk janë legalizuar. Pjesëmarrësit nga diskutimi i fokus grupeve serbe në anën tjetër ngritën çështjet e tyre për çështjet e infrastrukturës në lidhje me shkollat dhe spitalet brenda komunës së tyre. Ata deklaruan se qeveria e Serbisë ka dhuruar mjete për ndërtimin e objekteve të ndryshme shëndetësore, por qytetarët mbeten të painformuar se ku ndodheshin këto mjete monetare.

Të pranishmit u shprehën se është me rëndësi të madhe që qytetarëve t'u jepet mundësia për të marrë pjesë aktive në planifikimin e projekteve kapitale brenda komunës së tyre. Ata besojnë se autoritetet komunale duhet të zgjerojnë informimin e tyre ndaj qytetarëve për planifikimin hapësinor përmes broshurave, komunikimit përmes një përfaqësuesi të lagjes dhe/ose përmes kanaleve të tjera informuese. Sipas tyre, qytetarët duhet të përfaqësojnë një komponent thelbësor në planifikimin hapësinor për komunën e tyre, duke pasur parasysh se ata janë akterët që mbeten më të prekurit nga çdo veprim që merret.

Kënaqshmëria e përgjithshme me komunat

Ky studim, ndër të tjera, u ofroi të anketuarve mundësinë për të vlerësuar nivelin e kënaqshmërisë në lidhje me performancën e përgjithshme të komunës, kryetarit, kuvendit komunal, administratës lokale dhe shërbimeve komunale.

Në përgjithësi, shumica e të anketuarve (75%) janë deri diku të kënaqur/plotësisht të kënaqur me performancën e komunave të tyre. Të anketuarit nga Parteshi kanë treguar nivelin më të lartë të kënaqshmërisë me performancën e përgjithshme të komunës së tyre, ndërsa të anketuarit që kanë treguar shkallën më të lartë të pakënaqësisë janë nga Leposaviqi (92%) dhe Mitrovica e Veriut (91%).

Për më tepër, 66 për qind e të anketuarve janë deri diku/plotësisht të kënaqur me kryetarin e komunës së tyre. Gjatë vlerësimit të shkallës së kënaqshmërisë me kryetarin e komunës, rreth 99 për qind e të anketuarve nga Kaçaniku thanë se ishin plotësisht të kënaqur/deri diku të kënaqur, të pasuar nga 98 për qind e të anketuarve nga Suhareka dhe përqindje e njëjtë e atyre nga Hani i Elezit dhe Pejës (98%). Plotësisht të kënaqur/deri diku të kënaqur ishin edhe të anketuarit nga Deçani (94%), Parteshi (92%) dhe Klina (86%). Në anën tjetër, shumica dërrmuese e të anketuarve nga Novobërda (97%) deklaruan se nuk janë aspak të kënaqur/disi të pakënaqur me kryetarin e komunës së tyre. Nivele të larta të pakënaqësisë janë shfaqur edhe te të anketuarit nga Mitrovica e Veriut (90%), Leposaviqi (90%), Shtërpca (89%) dhe Graçanica (72%).

Më tej, shumica e të anketuarve (71%) kanë raportuar se janë të kënaqur me Kuvendin Komunal. Nëntëmbëdhjetë për qind janë disi të pakënaqur dhe rreth gjashtë për qind nuk janë aspak të kënaqur. Të gjithë të anketuarit nga Parteshi raportuan se ishin të kënaqur me Kuvendin e tyre Komunal, të ndjekur nga shumica dërrmuese e të anketuarve nga Suhareka (99%), Kaçaniku (97%), Deçani (94%), Mamusha (93%) dhe Peja (91%). Në anën tjetër, shumica e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut (90%), Leposaviqi (86%) dhe Graçanica (71%) janë të pakënaqur me Kuvendin Komunal.

Të dhënat tregojnë se niveli i kënaqshmërisë me administratën lokale në komunat e tyre është mjaft i lartë (75%). Megjithatë, 22 për qind e të anketuarve janë disi të pakënaqur/aspak të kënaqur me administratën lokale. Të gjithë të anketuarit nga Mamusha dhe Parteshi deklaruan se ishin të kënaqur me administratën e tyre lokale. Për më tepër, sipas rezultateve të anketës, të anketuarit nga Malisheva (98%), Suhareka (98%), Kaçaniku (97%), Deçani (94%) dhe Peja (98%) janë të kënaqur me administratën e tyre lokale. Përkundrazi, të anketuarit nga Mitrovica e Veriut (89%), Leposaviqi (88%), Shtërpca (69%) Novobërda (68%) dhe Istogu (62%) janë të pakënaqur me administratën e tyre lokale.

Në fund, shumica e qytetarëve të anketuar (78%) janë deri diku/plotësisht të kënaqur me shërbimet në komunat e tyre. Megjithatë, 14 për qind e tyre janë disi të pakënaqur me këto shërbime dhe katër për qind nuk janë aspak të kënaqur. Duke i zbërthyer rezultatet sipas komunës, vërejmë se pothuajse të gjithë të anketuarit nga Kaçaniku (99%) janë të kënaqur me shërbimet e tyre komunale, pasuar nga ata nga Suhareka (98%) dhe përqindja e njëjtë e të anketuarve nga Hani i Elezit dhe Malisheva (97%). Të anketuarit nga Mitrovica e Veriut (85%), Leposaviqi (83%) dhe Graçanica (72%) janë të pakënaqur me shërbimet e tilla.




Figura 35. Ju lutemi vlerësoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me...

Përgjigjet e marra nga diskutimet në fokus grupe me qytetarë nënkuptojnë se është shumë herët për të bërë vlerësime mbi kënaqshmërinë me institucionet e lartpërmendura, duke pasur parasysh se shumica e pjesëmarrësve i përkasin komunave që kanë kaluar nëpër një tranzicion të pushtetit lokal së fundmi. Megjithatë, pjesëmarrësit nga diskutimi i fokus grupeve të burrave përmendën se është bërë punë e madhe sa i përket vendimit të kryetarit të komunës për ndërprerjen e ndërtimeve në zonat historike. Të tjerë megjithatë shprehën pakënaqësinë e tyre për punën e pushteteve të mëparshme lokale, veçanërisht duke specifikuar se një vëmendje e madhe i është kushtuar ndërtimit dhe infrastrukturës, duke lënë kështu mjaft të neglizhuara çështjet sociale.

Më tej, për të rritur kënaqshmërinë e qytetarëve me institucionet e lartpërmendura, pjesëmarrësit deklaruan se është e një rëndësie thelbësore të rritet angazhimi i qytetarëve në vendimmarrje. Ata rekomanduan që asambleistët të takohen çdo muaj me qytetarët për të diskutuar çështje të ndryshme që janë të rëndësishme brenda komunës së tyre. Po ashtu, ata edhe një herë theksuan çështjen e informimit të qytetarëve për planifikimin buxhetor, planifikimin hapësinor dhe vendimet tjera relevante komunale.

Në pyetjen nëse janë të kënaqur me jetesën në komunat e tyre, 68 përqind e të anketuarve janë shprehur të kënaqur, ndërsa 32 përqind e tyre kanë shprehur të kundërtën.




Figura 36. A jeni të kënaqur me jetesën në komunën tuaj?

Kur iu prezantua gjetja e lartpërmendur që sugjeron se 32 për qind e të anketuarve nuk janë të kënaqur me jetesën në komunën e tyre, pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupeve shprehën bindjen se kjo përqindje është edhe më e theksuar në realitet. Ata në përgjithësi pakënaqësinë e qytetarëve ia atribuon niveleve të ulëta të punësimit, cilësisë së dobët të arsimit, infrastrukturës joadekuate, ekonomisë, cilësisë jo të duhur të sistemit shëndetësor dhe çështjeve të tjera që bëjnë që qytetarët e Kosovës të përjetojnë pakënaqësi me gjendjen e tyre të jetesës. Për më tepër, duke marrë parasysh se nepotizmi paraqet një problem rrënjësor për qytetarët e Kosovës, pjesëmarrësit duket se kanë zhvilluar një ndjenjë të pafuqishmërisë së fituar (pa aftësisë së fituar për të ndihmuar veten). Në këtë mënyrë, ata duket se kanë krijuar mendësinë se arsimi nuk korr rezultate të frytshme në kurorëzimin me punësim për shkak se rekrutimi kryhet bazuar në ndikime politike dhe lidhje familjare.

Të anketuarve u është kërkuar edhe mendimi i tyre për vizionin që kanë për të ardhmen e komunave të tyre, përkatësisht nëse konsiderojnë se komuna e tyre është në drejtimin e duhur për të qenë një vend më i mirë pas 5 vitesh. Bazuar në rezultatet, 73 për qind e të anketuarve besojnë se komuna e tyre është në drejtimin e duhur për të qenë në një vend më i mirë pas pesë vitesh. Megjithatë, 27 për qind e të anketuarve nuk janë dakord me këtë të fundit.

Rreth 97 për qind e të anketuarve nga Kaçaniku mendojnë se komuna e tyre është në drejtimin e duhur për të qenë një vend më i mirë pas 5 vitesh. Shumica dërmuese e të anketuarve nga Suhareka (95%) mendojnë të njëjtën gjë për komunën e tyre. Përkundrazi, të gjithë të anketuarit nga Zubin Potoku mendojnë se komuna e tyre nuk është në drejtimin e duhur për të qenë një vend më i mirë pas 5 vitesh, të pasuar nga të anketuarit nga Leposaviqi (98%), Mitrovica e Veriut (97%) dhe Graçanica (86%) që mendojnë të njëjtën gjë.




Figura 37. A mendoni se komuna juaj është në drejtimin e duhur për të qenë një vend më i mirë pas 5 vitesh?

Për sa i përket pyetjes nëse pjesëmarrësit që marrin pjesë në diskutimet e fokus grupeve presin që jeta në komunë të përmirësohet, përkeqësohet apo të mbetet e njëjtë në 4 vitet e ardhshme, përgjigjet dukej se ndryshonin. Pjesëmarrësit nga fokus grupi i burrave dhanë pikëpamje më optimiste duke deklaruar se me kryetarin e ri të zgjedhur besojnë se situata brenda komunës së tyre vetëm do të përmirësohet. Pjesëmarrësit nga diskutimi i fokus grupeve serbe nga ana tjetër kishin pak shpresa për përmirësim, përkundrazi, besonin se situata vetëm do të përkeqësohej në kohët e ardhshme. Pjesëmarrësit besojnë se me koordinimin dhe bashkëpunimin e duhur ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror të qeverisjes, udhëheqësve të tyre u jepet autoriteti për të krijuar mundësi punësimi, që sipas tyre është i vetmi hap për një mënyrë jetese dinjitoze.



Në fund, të anketuarit janë pyetur nëse kanë votuar në zgjedhjet e fundit komunale (2021). Shumica dërmuese e të anketuarve (81%) kanë deklaruar se kanë votuar në zgjedhjet e fundit komunale, ndërsa rreth 17 për qind e tyre kanë deklaruar se nuk e kanë bërë këtë. Një për qind e të anketuarve nuk kishin të drejtë vote dhe një për qind e tyre refuzuan të përgjigjen.




Figura 38. A keni votuar në zgjedhjet e fundit komunale (2021)?

Përfundimi

Në përgjithësi, studimi tregon se shumica e të anketuarve janë të informuar për vendimet që merr komuna e tyre dhe pothuajse gjysma e këtyre të anketuarve informohen për këto vendime gojë pas goje. Edhe pse të anketuarit duket se janë të informuar për vendimet, shumica e të anketuarve duket se nuk kanë pasur ndonjë ndërveprim me komunën e tyre në 12 muajt e fundit. Nga ata që janë përfshirë/angazhuar me komunën e tyre, më shumë se gjysma kanë ngritur çështje rreth infrastrukturës lokale, ndërsa shumica e këtyre qytetarëve kanë deklaruar se komuna nuk është përgjigjur për këtë. Sipas takimeve publike, shumica e qytetarëve të intervistuar pajtohen/pajtohen plotësisht që autoritetet komunale marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë këtyre takimeve.

Sa i përket Kuvendit Komunal, më shumë se gjysma e të anketuarve pohuan se janë mesatarisht/krejtësisht në dijeni për rolin e tij, edhe pse shumica e tyre pohuan se nuk kanë takuar asnjë anëtar të kuvendit komunal dhe as nuk kanë marrë pjesë në ndonjë seancë të kuvendit komunal në 12 muajt e fundit. Përveç kësaj, më shumë se gjysma e të anketuarve raportuan se ishin të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal dhe cilësinë e punës në projektet infrastrukturore në komunën e tyre. Mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse u ofrohen grave nga komuna deri në njëfarë mase, kjo është pohuar nga më shumë se gjysma e të anketuarve. Për më tepër, shërbimet administrative dhe parësore shëndetësore duket se janë shërbimet komunale më të përdorura në 12 muajt e fundit. Rezultatet tregojnë se qytetarët duket se janë deri diku të kënaqur me planifikimin hapësinor në komunën e tyre.

Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve të intervistuar në lidhje me performancën e përgjithshme të komunës, kryetarit, kuvendit komunal, administratës lokale dhe shërbimeve komunale duket të jetë në nivel të lartë pasi që shumica e tyre raportuan të jenë deri diku/plotësisht të kënaqur me performancën e komunave të tyre. Të anketuarit duket se janë gjithashtu të kënaqur me jetesën në komunën e tyre. Së fundi, ata duket se janë optimistë për të ardhmen pasi shumica e tyre mendojnë se komuna e tyre është në drejtimin e duhur për të qenë një vend më i mirë pas pesë vitesh.



Shtojca

Tabelat tërthore (crosstabs) me komnat

1. Sa jeni të informuar për vendimet që merr komuna juaj?					
Komuna	Aspak i informuar	Deri diku i informuar	Mjaft mirë i informuar	Plotësisht i informuar	Refuzoj/Nuk kam mendim
Deçan/Deçani	15.2%	66.7%	18.2%		
Dragash/Dragaš	16.8%	43.8%	32.8%	5.1%	1.5%
Ferizaj/Uroševac	7.6%	53.1%	31.2%	4.0%	4.0%
Fushë Kosovë	1.8%	49.6%	35.4%	13.3%	
Gjakovë//Đakovica	6.6%	33.3%	58.3%	1.7%	
Gjilan/Gnjilane	33.2%	47.7%	12.4%	6.7%	
Glllogovc/Glogovac	19.1%	41.1%	30.1%	8.6%	1.0%
Graçanicë/Gračanica	30.8%	49.2%	13.8%	6.2%	
Hani i Elezit/Elez Han	67.7%	29.0%	3.2%		
Istog/Istok	19.7%	62.0%	15.5%	2.8%	
Junik/Junik	19.0%	33.3%	38.1%	9.5%	
Kamenicë/Kamenica	36.2%	52.6%	11.2%		
Kaçanik/Kaçanik	9.3%	47.5%	39.0%	3.4%	0.8%
Klinë/Klina	63.8%	29.6%	3.9%	2.6%	
Kllokot/Klokot	15.4%	61.5%	15.4%	7.7%	
Leposaviq/Leposavić	9.8%	37.3%	45.1%	5.9%	2.0%
Lipjan/Lipljan	16.2%	49.5%	21.1%	12.7%	0.5%
Malishevë/Mališevo	11.1%	77.4%	10.6%	0.4%	0.4%
Mamushë/Mamuša	26.7%	66.7%	6.7%		
Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	3.7%	26.9%	63.9%	5.6%	
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica	8.3%	50.9%	31.5%	9.3%	
Novobërdë/Novo Brdo	74.2%	16.1%	6.5%	3.2%	
Obiliq/Obilić	22.4%	32.9%	37.6%	7.1%	
Partesh/Parteš	7.1%	28.6%	50.0%	14.3%	
Pejë/Peć	34.9%	51.1%	12.9%	1.1%	
Podujevë/Podujevo	15.8%	29.9%	36.3%	18.0%	
Prishtinë/Priština	6.2%	36.8%	41.0%	16.1%	
Prizren/Prizren	37.7%	39.1%	21.0%	2.2%	
Rahovec/Orahovac	33.0%	32.6%	26.2%	8.1%	
Ranillug/Ranilug	37.0%	40.7%	18.5%	3.7%	
Shtime/Štimlje	20.4%	54.1%	18.4%	4.1%	3.1%
Shtërpçë/Štrpce	57.8%	24.4%	15.6%		2.2%
Skenderaj/Srbica	35.1%	36.0%	18.9%	9.2%	0.9%
Suharekë/Suva Reka	1.2%	28.9%	53.7%	16.1%	
Viti/Vitina	39.9%	43.4%	16.2%	0.6%	
Vushtri/Vučitrn	23.1%	38.5%	31.8%	6.6%	
Zubin Potok/Zubin Potok	28.0%	8.0%	12.0%	8.0%	44.0%
Zveçan/Zvečan	11.5%	26.9%	46.2%	7.7%	7.7%

2. Në çfarë mënyrash komunikohen këto vendime?							
Komuna	Publikohen në ueb faqen e komunës	Komunikohen me postë	Komunikohen përmes Facebook-ut	Komunikohen përmes TV/ Radios lokale	Komunikohen gojë pas goje	Tjetër (Ju lutem specifikoni)	Nuk e di/Ref.
Deçan/Deçani	6.6%	0.5%	35.2%	48.3%	84.6%	0.0%	0.5%
Dragash/Dragaš	28.8%	20.9%	65.3%	48.2%	18.4%	0.0%	3.9%
Ferizaj/Uroševac	32.3%	3.0%	44.2%	11.3%	45.9%	0.0%	14.6%
Fushë Kosovë	15.4%	30.2%	34.5%	37.7%	44.1%	0.0%	1.1%
Gjakovë//Đakovica	4.7%	1.2%	30.3%	53.7%	68.7%	0.0%	0.0%
Gjilan/Gnjilane	29.2%	4.9%	37.3%	50.4%	37.3%	0.5%	18.8%
Glogovc/Glogovac	27.2%	7.2%	48.1%	25.3%	28.9%	0.0%	11.5%
Graçanicë/Gračanica	33.9%	1.3%	12.6%	37.5%	20.4%	0.0%	17.9%
Hani i Elezit/Elez Han	14.2%	2.5%	13.4%	0.0%	88.9%	0.6%	6.4%
Istog/Istok	0.5%	4.8%	37.4%	33.5%	38.4%	0.5%	17.8%
Junik/Junik	7.8%	1.7%	28.6%	15.6%	88.4%	0.0%	0.8%
Kamenicë/Kamenica	3.8%	0.9%	19.5%	7.0%	87.9%	0.0%	1.2%
Kaçanik/Kaçanik	66.2%	0.6%	69.6%	0.0%	95.5%	0.0%	3.4%
Klinë/Klina	8.5%	0.5%	26.8%	12.0%	85.4%	0.0%	5.1%
Kllokot/Klokot	38.6%	2.2%	36.9%	1.2%	22.5%	0.0%	42.1%
Leposaviq/Leposavić	43.1%	4.6%	59.2%	11.9%	12.4%	0.0%	2.5%
Lipjan/Lipljan	50.8%	4.8%	60.9%	20.2%	16.9%	0.0%	10.9%
Malishevë/Mališevo	22.3%	0.0%	36.1%	51.9%	92.4%	0.0%	7.6%
Mamushë/Mamuša	8.3%	0.5%	26.1%	48.9%	91.3%	1.9%	4.0%
Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	51.0%	2.2%	82.0%	3.4%	8.7%	0.0%	0.5%
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica	21.8%	6.6%	68.3%	42.3%	37.0%	0.0%	4.9%
Novobërdë/Novo Brdo	1.0%	0.1%	5.9%	6.0%	82.5%	0.0%	9.0%
Obiliq/Obilić	20.5%	6.8%	20.8%	15.0%	53.5%	0.0%	4.6%
Partesh/Parteš	21.7%	6.4%	17.3%	4.3%	82.7%	0.0%	1.6%
Pejë/Peć	4.3%	0.0%	11.1%	60.8%	30.3%	0.0%	13.6%
Podujevë/Podujevo	22.6%	5.7%	42.7%	49.3%	34.1%	0.0%	2.7%
Prishtinë/Priština	65.8%	19.4%	66.7%	55.0%	38.1%	0.0%	2.8%
Prizren/Prizren	28.7%	6.8%	45.0%	76.4%	19.1%	0.0%	6.2%
Rahovec/Orahovac	24.6%	1.1%	23.7%	7.1%	62.6%	0.0%	14.1%
Ranillug/Ranilug	32.4%	8.8%	24.0%	13.1%	82.1%	0.0%	6.1%
Shtime/Štimlje	24.6%	1.2%	26.4%	32.9%	42.2%	1.7%	13.0%
Shtërpçë/Štrpce	13.1%	2.1%	7.3%	40.0%	40.8%	0.0%	14.4%
Skenderaj/Srbica	44.4%	41.8%	40.3%	9.1%	65.7%	0.5%	4.3%
Suharekë/Suva Reka	49.8%	15.5%	90.2%	49.3%	76.0%	0.0%	0.5%
Viti/Vitina	18.3%	6.0%	37.9%	38.9%	52.0%	1.0%	6.0%
Vushtri/Vučitrn	23.5%	3.8%	45.3%	28.7%	60.9%	0.5%	8.4%
Zubin Potok/Zubin Potok	18.2%	1.2%	19.5%	0.0%	30.5%	0.0%	44.6%
Zveçan/Zvečan	1.3%	12.7%	26.1%	20.6%	33.1%	0.0%	15.5%



3. Në 12 muajt e fundit, a i keni vizituar me sa vijon?				
Komuna	Ueb faqja e komunës	Faqja në Facebook e Komunës	Tjetër (ju lutem specifikoni)	Asnjëra
Deçan/Deçani	6.7%	26.5%	0.0%	73.0%
Dragash/Dragaš	44.5%	77.9%	0.0%	13.6%
Ferizaj/Uroševac	21.2%	54.5%	0.0%	43.0%
Fushë Kosovë	49.2%	42.7%	0.0%	30.0%
Gjakovë//Đakovica	5.9%	34.6%	0.5%	64.4%
Gjilan/Gnjilane	22.0%	26.3%	0.5%	61.3%
Glllogovc/Glogovac	26.5%	60.7%	2.1%	25.4%
Graçanicë/Gračanica	3.8%	30.2%	0.0%	68.7%
Hani i Elezit/Elez Han	12.8%	15.0%	0.0%	83.9%
Istog/Istok	6.7%	9.9%	0.5%	86.6%
Junik/Junik	10.2%	24.3%	0.0%	75.0%
Kamenicë/Kamenica	4.4%	17.8%	0.0%	80.9%
Kaçanik/Kaçanik	41.6%	67.0%	0.0%	31.1%
Klinë/Klina	5.1%	24.3%	0.0%	75.7%
Klllokot/Klokot	37.0%	35.9%	0.0%	61.9%
Leposaviq/Leposavić	14.3%	83.3%	0.0%	9.5%
Lipjan/Lipljan	50.6%	72.8%	0.0%	19.1%
Malishevë/Mališevo	25.5%	39.8%	0.0%	60.7%
Mamushë/Mamuša	9.3%	25.4%	0.5%	74.6%
Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	11.5%	88.5%	0.0%	4.0%
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica	21.7%	60.6%	0.0%	34.8%
Novobërdë/Novo Brdo	2.0%	5.6%	0.0%	93.4%
Obiliq/Obilić	20.0%	29.8%	0.0%	57.9%
Partesh/Parteš	19.8%	21.2%	0.0%	75.4%
Pejë/Peć	5.8%	10.8%	0.0%	87.6%
Podujevë/Podujevo	19.6%	44.0%	1.9%	53.8%
Prishtinë/Priština	59.8%	66.5%	2.6%	13.1%
Prizren/Prizren	25.1%	39.3%	1.0%	58.6%
Rahovec/Orahovac	17.9%	21.0%	0.0%	75.7%
Ranillug/Ranilug	34.3%	26.8%	0.0%	66.0%
Shtime/Štimlje	14.0%	43.2%	1.7%	54.0%
Shtërpcë/Štrpce	9.7%	18.4%	0.0%	81.6%
Skenderaj/Srbica	19.6%	56.7%	0.5%	43.2%
Suharekë/Suva Reka	56.9%	89.2%	0.5%	9.2%
Viti/Vitina	12.7%	31.5%	0.0%	65.3%
Vushtri/Vučitrn	30.2%	41.7%	0.0%	49.7%
Zubin Potok/Zubin Potok	10.2%	26.1%	0.0%	66.4%
Zveçan/Zvečan	0.7%	24.7%	0.0%	74.6%

4. Për çfarë arsye?						
Komuna	Informacione në lidhje me tenderët publikë	Informacione në lidhje me dëgjimet publike	Vende pune	Subvencionet	Buxheti i komunës dhe shpenzimet	Tjetër, ju lutem specifikoni
Deçan/Dečani	11.3%	5.0%	84.2%	50.7%	10.3%	0.0%
Dragash/Dragaš	19.9%	47.3%	57.1%	7.8%	9.6%	6.3%
Ferizaj/Uroševac	11.0%	30.0%	77.7%	42.1%	4.2%	0.0%
Fushë Kosovë	32.9%	50.5%	56.6%	24.8%	15.3%	0.0%
Gjakovë//Đakovica	5.9%	30.6%	68.4%	47.8%	21.9%	0.0%
Gjilan/Gnjilane	15.0%	11.1%	74.4%	14.7%	18.3%	19.0%
Glogovc/Glogovac	7.4%	35.2%	62.2%	19.8%	15.2%	1.4%
Graçanicë/Gračanica	9.3%	11.1%	73.4%	9.3%	5.7%	0.0%
Hani i Elezit/Elez Han	0.0%	26.7%	79.3%	48.9%	5.9%	0.0%
Istog/Istok	5.6%	21.1%	68.6%	17.6%	5.6%	3.9%
Junik/Junik	4.8%	7.6%	90.9%	63.8%	48.3%	0.0%
Kamenicë/Kamenica	15.8%	19.0%	50.7%	47.4%	21.4%	0.0%
Kaçanik/Kaçanik	0.0%	1.7%	64.2%	78.7%	1.7%	3.3%
Klinë/Klina	27.3%	47.4%	53.1%	92.6%	17.0%	3.1%
Klokot/Klokot	17.9%	6.4%	73.0%	32.8%	37.3%	0.0%
Leposaviq/Leposavić	10.1%	7.8%	59.8%	25.7%	9.3%	0.0%
Lipjan/Lipljan	19.9%	18.5%	73.6%	42.9%	13.4%	2.8%
Malishevë/Mališevo	9.8%	44.3%	82.1%	7.6%	28.7%	0.0%
Mamushë/Mamuša	17.2%	26.9%	65.9%	25.8%	22.6%	7.0%
Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	7.8%	6.7%	70.4%	19.6%	3.3%	0.0%
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica	12.3%	28.3%	65.7%	14.9%	13.2%	3.1%
Novobërdë/Novo Brdo	0.0%	0.0%	84.7%	51.6%	66.6%	0.0%
Obiliq/Obilić	1.4%	14.9%	73.1%	24.7%	15.8%	0.0%
Partesh/Parteš	43.8%	40.9%	49.6%	65.9%	33.6%	0.0%
Pejë/Peć	29.7%	16.7%	43.3%	44.0%	16.7%	8.4%
Podujevë/Podujevo	14.8%	44.7%	57.2%	44.2%	24.7%	0.0%
Prishtinë/Priština	41.9%	43.2%	76.9%	44.1%	24.6%	0.0%
Prizren/Prizren	14.1%	42.2%	49.8%	58.6%	54.0%	1.1%
Rahovec/Orahovac	19.1%	13.6%	66.5%	60.6%	36.1%	0.0%
Ranillug/Ranilug	59.6%	35.4%	77.3%	75.8%	49.8%	0.0%
Shtime/Štimlje	6.1%	13.3%	75.6%	35.5%	8.3%	0.0%
Shtërpçë/Štrpce	20.4%	37.6%	93.3%	20.6%	20.2%	0.0%
Skenderaj/Srbica	30.6%	37.1%	83.7%	23.5%	6.6%	0.9%
Suharekë/Suva Reka	23.4%	66.1%	92.7%	58.7%	42.5%	0.0%
Viti/Vitina	7.4%	4.1%	75.9%	30.9%	6.1%	14.3%
Vushtrri/Vučitrn	20.8%	40.7%	71.7%	26.9%	2.1%	2.4%
Zubin Potok/Zubin Potok	12.0%	4.9%	49.8%	27.1%	20.2%	0.0%
Zveçan/Zvečan	0.0%	0.0%	65.5%	53.6%	11.9%	0.0%



5. A e gjetët informacionin/shërbimin e kërkuar?		
Komuna	Po	Jo
Deçan/Deçani	91.4%	8.6%
Dragash/Dragaš	57.1%	42.9%
Ferizaj/Uroševac	83.1%	16.9%
Fushë Kosovë	67.5%	32.5%
Gjakovë//Đakovica	65.3%	34.7%
Gjilan/Gnjilane	74.3%	25.7%
Glllogovc/Glogovac	55.1%	44.9%
Graçanicë/Gračanica	20.0%	80.0%
Hani i Elezit/Elez Han	80.0%	20.0%
Istog/Istok	45.0%	55.0%
Junik/Junik	80.0%	20.0%
Kamenicë/Kamenica	40.9%	59.1%
Kaçanik/Kaçanik	89.0%	11.0%
Klinë/Klina	86.5%	13.5%
Klllokot/Klokot	80.0%	20.0%
Leposaviq/Leposavić	30.4%	69.6%
Lipjan/Lipljan	81.4%	18.6%
Malishevë/Mališevo	100.0%	
Mamushë/Mamuša	100.0%	
Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	23.8%	76.2%
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica	84.6%	15.4%
Novobërdë/Novo Brdo	50.0%	50.0%
Obiliq/Obilić	54.3%	45.7%
Partesh/Parteš	66.7%	33.3%
Pejë/Peć	68.2%	31.8%
Podujevë/Podujevo	65.3%	34.7%
Prishtinë/Priština	87.9%	12.1%
Prizren/Prizren	91.7%	8.3%
Rahovec/Orahovac	94.8%	5.2%
Ranillug/Ranilug	88.9%	11.1%
Shtime/Štimlje	69.6%	30.4%
Shtërpçë/Štrpce	44.4%	55.6%
Skenderaj/Srbica	93.1%	6.9%
Suharekë/Suva Reka	95.5%	4.5%
Viti/Vitina	50.0%	50.0%
Vushtri/Vučitrn	50.3%	49.7%
Zubin Potok/Zubin Potok	12.5%	87.5%
Zveçan/Zvečan		100.0%

6. Sa lehtë e gjetët informacionin që ju nevojitet? Ueb-faqja e Komunës					
Komuna	Shumë vështirë	Vështirë	Lehtë	Shumë lehtë	Refuzoj të përgjigjem / Nuk...
Deçan/Deçani		8.3%	41.7%	16.7%	33.3%
Dragash/Dragaš	2.5%	8.3%	52.5%	35.8%	0.8%
Ferizaj/Uroševac		5.8%	45.2%	45.2%	3.7%
Fushë Kosovë	12.5%	10.0%	28.8%	46.3%	2.5%
Gjakovë//Đakovica		34.4%	58.4%	1.6%	5.6%
Gjilan/Gnjilane	6.8%	6.8%	34.0%	49.7%	2.7%
Glogovc/Glogovac	0.6%	18.7%	50.3%	23.2%	7.1%
Graçanicë/Gračanica	4.8%	19.0%	52.4%	14.3%	9.5%
Hani i Elezit/Elez Han			80.0%	20.0%	
Istog/Istok	20.0%	15.0%	25.0%	35.0%	5.0%
Junik/Junik		16.7%	16.7%	50.0%	16.7%
Kamenicë/Kamenica	4.5%	31.8%	50.0%	13.6%	
Kaçanik/Kaçanik			34.1%	64.6%	1.2%
Klinë/Klina		5.4%	83.8%	8.1%	2.7%
Klokot/Klokot			80.0%	20.0%	
Leposaviq/Leposavić	8.5%	55.3%	34.0%		2.1%
Lipjan/Lipljan	1.2%	7.2%	62.0%	26.5%	3.0%
Malishevë/Mališevo			60.6%	11.7%	27.7%
Mamushë/Mamuša	33.3%		33.3%	33.3%	
Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	1.9%	45.2%	43.3%	3.8%	5.8%
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica	4.9%	6.3%	58.7%	25.9%	4.2%
Novobërdë/Novo Brdo				50.0%	50.0%
Obiliq/Obilić	11.1%	13.9%	36.1%	36.1%	2.8%
Partesh/Parteš			66.7%	33.3%	
Pejë/Peć	9.1%		70.5%	11.4%	9.1%
Podujevë/Podujevo		11.8%	52.1%	32.6%	3.5%
Prishtinë/Priština	5.3%	16.9%	40.7%	34.4%	2.7%
Prizren/Prizren	1.1%	3.8%	31.6%	57.9%	5.6%
Rahovec/Orahovac		5.2%	44.8%	44.8%	5.2%
Ranillug/Ranilug			55.6%	44.4%	
Shtime/Štimlje	6.4%	4.3%	29.8%	51.1%	8.5%
Shtërpçë/Štrpce		12.5%	25.0%	50.0%	12.5%
Skenderaj/Srbica	2.3%	21.4%	46.6%	29.0%	0.8%
Suharekë/Suva Reka	0.5%	3.2%	17.6%	61.5%	17.2%
Viti/Vitina		26.7%	40.0%	31.7%	1.7%
Vushtrri/Vučitrn	2.8%	65.0%	21.0%	9.1%	2.1%
Zubin Potok/Zubin Potok		50.0%	25.0%	12.5%	12.5%
Zveçan/Zvečan			66.7%	33.3%	



6. Sa lehtë e gjetët informacionin që ju nevojitet? Faqja në Facebook					
Komuna	Shumë vështirë	Vështirë	Lehtë	Shumë lehtë	Refuzoj të përgjigjem / Nuk...
Deçan/Deçani		2.9%	34.3%	60.0%	2.9%
Dragash/Dragaš	1.7%	17.6%	45.4%	34.5%	0.8%
Ferizaj/Uroševac	0.8%	14.1%	34.0%	48.5%	2.5%
Fushë Kosovë	11.1%	11.1%	37.0%	39.5%	1.2%
Gjakovë//Đakovica		16.8%	30.4%	51.2%	1.6%
Gjilan/Gnjilane	8.8%	10.8%	27.0%	53.4%	
Glogovc/Glogovac	1.3%	19.2%	46.8%	27.6%	5.1%
Graçanicë/Gračanica	14.3%	33.3%	47.6%	4.8%	
Hani i Elezit/Elez Han			80.0%	20.0%	
Istog/Istok	21.1%	10.5%	26.3%	31.6%	10.5%
Junik/Junik			20.0%	80.0%	
Kamenicë/Kamenica		34.8%	43.5%	21.7%	
Kaçanik/Kaçanik			33.3%	65.4%	1.2%
Klinë/Klina		2.7%	86.5%	10.8%	
Kllokot/Klokot			75.0%	25.0%	
Leposaviq/Leposavić	2.2%	17.4%	73.9%	4.3%	2.2%
Lipjan/Lipljan	0.6%	4.8%	47.9%	44.9%	1.8%
Malishevë/Mališevo			86.2%	13.8%	
Mamushë/Mamuša			50.0%	50.0%	
Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica		26.9%	55.8%	11.5%	5.8%
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica		4.2%	52.4%	41.3%	2.1%
Novobërdë/Novo Brdo			50.0%	50.0%	
Obiliq/Obilić	5.6%	41.7%	25.0%	25.0%	2.8%
Partesh/Partesh			50.0%	50.0%	
Pejë/Peć	9.1%	4.5%	70.5%	11.4%	4.5%
Podujevë/Podujevo	1.4%	9.1%	42.0%	45.5%	2.1%
Prishtinë/Priština	1.2%	16.8%	45.3%	35.5%	1.2%
Prizren/Prizren		2.6%	35.0%	62.4%	
Rahovec/Orahovac			50.0%	46.6%	3.4%
Ranillug/Ranilug		11.1%	44.4%	44.4%	
Shtime/Štimlje	6.5%	6.5%	34.8%	45.7%	6.5%
Shtërpcë/Štrpce		25.0%	62.5%	12.5%	
Skenderaj/Srbica	0.8%	0.8%	29.0%	69.5%	
Suharekë/Suva Reka		1.8%	5.9%	90.4%	1.8%
Viti/Vitina		18.3%	46.7%	33.3%	1.7%
Vushtri/Vučitrn	8.3%	33.3%	37.5%	20.8%	
Zubin Potok/Zubin Potok		28.6%	42.9%	14.3%	14.3%
Zveçan/Zvečan		42.9%	57.1%		

7. A e kuptuat lehtë informacionin që gjetët të publikuar nga komuna?					
Komuna	Aspak e kuptueshme	Deri diku të pakuptueshme	Deri diku të kuptueshme	Shumë të kuptueshme	Refuzoj të përgjigjem / Nuk...
Deçan/Dečani		5.7%	51.4%	42.9%	
Dragash/Dragaš	0.8%	17.6%	53.8%	27.7%	
Ferizaj/Uroševac		21.5%	49.2%	19.4%	9.9%
Fushë Kosovë	7.4%	30.9%	39.5%	21.0%	1.2%
Gjakovë//Đakovica		12.8%	71.2%	16.0%	
Gjilan/Gnjilane	6.8%	12.8%	40.5%	39.9%	
Gllgovc/Glogovac	1.3%	16.0%	46.8%	35.9%	
Graçanicë/Gračanica	28.6%	23.8%	38.1%	9.5%	
Hani i Elezit/Elez Han		33.3%	50.0%	16.7%	
Istog/Istok	20.0%	15.0%	30.0%	35.0%	
Junik/Junik			75.0%	25.0%	
Kamenicë/Kamenica	4.5%	36.4%	31.8%	27.3%	
Kaçanik/Kaçanik		4.9%	69.1%	25.9%	
Klinë/Klina		2.7%	32.4%	64.9%	
Kllkot/Klokot		16.7%	66.7%	16.7%	
Leposaviq/Leposavić	2.2%	8.7%	82.6%	4.3%	2.2%
Lipjan/Lipljan	0.6%	12.0%	39.8%	47.0%	0.6%
Malishevë/Mališevo			42.6%	56.4%	1.1%
Mamushë/Mamuša			50.0%	50.0%	
Mitrovicë e Veriut/ Severna Mitrovica		8.6%	80.0%	8.6%	2.9%
Mitrovicë e Jugut/Južna Mitrovica	1.4%	10.5%	55.9%	31.5%	0.7%
Novobërdë/Novo Brdo			100.0%		
Obiliq/Obilić	8.6%	22.9%	60.0%	8.6%	
Partesh/Parteš		25.0%	50.0%	25.0%	
Pejë/Peć		4.5%	50.0%	45.5%	
Podujevë/Podujevo		9.1%	62.9%	28.0%	
Prishtinë/Priština	0.7%	22.6%	50.5%	26.2%	
Prizren/Prizren		1.1%	88.3%	10.5%	
Rahovec/Orahovac		5.3%	43.9%	50.9%	
Ranillug/Ranilug		10.0%	50.0%	40.0%	
Shtime/Štimlje	4.3%	34.8%	43.5%	15.2%	2.2%
Shtërpçë/Štrpce		25.0%	75.0%		
Skenderaj/Srbica		12.2%	60.3%	26.7%	0.8%
Suharekë/Suva Reka		1.4%	48.6%	50.0%	
Viti/Vitina		20.0%	73.3%	6.7%	
Vushtri/Vučitrn		28.5%	45.1%	26.4%	
Zubin Potok/Zubin Potok	11.1%		66.7%	11.1%	11.1%
Zveçan/Zvečan		42.9%	42.9%	14.3%	



8. Si keni ndërrëpunuar me komunën tuaj në 12 muajt e fundit (përveç gjatë fushatës elektorale)?					
Komuna	Kam marrë pjesë në takime publike (dëgjime publike, takime me kryetarin e komunës, etj.)	Përmes takimeve individuale (me kryetarin e komunës, drejtorin, anëtarin e KK)	Nëpërmjet nismave të përbashkëta të komunitetit (këshilli i fshatit/lagjes, organizatat e shoqërisë civile, etj.)	Nuk kam pasur asnjë ndërrëpunim	Të tjera (ju lutem specifikoni)
Deçan/Deçani	4.9%	3.8%	6.4%	88.6%	0.0%
Dragash/Dragaš	40.2%	45.1%	19.7%	39.6%	0.0%
Ferizaj/Uroševac	21.7%	16.7%	9.4%	58.9%	0.0%
Fushë Kosovë	45.1%	40.0%	28.5%	32.4%	0.0%
Gjakovë//Đakovica	1.0%	3.7%	5.3%	94.2%	0.0%
Gjilan/Gnjilane	6.3%	4.7%	2.6%	89.1%	0.0%
Glogovc/Glogovac	4.8%	19.0%	20.2%	58.1%	0.0%
Graçanicë/Gračanica	3.7%	3.6%	2.5%	90.4%	0.0%
Hani i Elezit/Elez Han	2.2%	0.0%	1.0%	97.3%	0.0%
Istog/Istok	3.4%	8.7%	9.8%	84.4%	0.6%
Junik/Junik	1.5%	1.9%	0.5%	96.5%	0.6%
Kamenicë/Kamenica	4.8%	3.2%	11.6%	87.0%	0.0%
